

TË PAGUASH APO TË MOS PAGUASH

INFORMALITETI
NGA KËNDVËSHTRIMI
I BIZNESEVE
NË KOSOVË



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



KFOS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

**TË PAGUASH
APO TË MOS
PAGUASH**

INFORMALITETI
NGA KËNDVËSHTRIMI
I BIZNESEVE
NË KOSOVË

Ky publikim është realizuar me angazhimin e Zyrës së
Friedrich Ebert Stiftung (FES) në Kosovë; Fondacionit
Kosovarë për Shoqëri të Hapur (KFOS); dhe Institutit për
Hulumtime Zhvillimore Riinvest



Deklaratë mohimi:

Pikëpamjet e shfaqura në këtë raport janë të autorëve dhe jo
domosdoshmërisht i përfaqësojnë ato të mbështetësve.

**Përgatitur nga:
INSTITUTI RIINVEST**

Etida Zeka, Premton Hyseni, Julia Leuther, Gent Beqiri,
Lumir Abdixhiku, Alban Hashani, Agon Nixha



Rastet e studimit të përgatitura nga:

Besiana Xharra, ZERI

Publikuar nga:

INSTITUTI RIINVEST
Lidhja e Prizrenit nr. 42
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320; 223816
www.riinvestinstitute.org

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk shprehin domosdoshmërisht ato të Friedrich-Ebert-Stiftung (FES).
Përdorimi komercial i mediave të publikuara nga Friedrich-Ebert-Stiftung nuk është i lejuar pa pëlqimin me shkrim nga FES.
Te gjitha te drejtat e shpërndarjes të këtij publikimi janë të rezervuara nga Friedrich-Ebert-Stiftung.
Të gjitha tekstet gjenden online www.fes-prishtina.org

E drejta autoriale © 2013 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në
ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa
lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

Shkurtesat

BIRN → Rrjeti Ballkanik për Raportim Hetues

AKR → Aleanca Kosova e Re

ATK → Administrata Tatimore e Kosovës

BPV → Bruto Prodhimi Vendor

BSPK → Bashkimin e Sindikatës së Pavarur të Kosovës

EC → Komisioni European

FMN → Fondi Monetar Ndërkombëtar

MPMS → Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MTI → Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

OECD → Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

ONP → Organizata Ndërkombëtare e Punës

SNK → Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

TVSH → Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

UNDP → Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara

WVS → World Value Survey

Përmbajtja

GJETJET KRYESORE TË HULUMTIMIT	8
1. DEFINICIONI I INFORMALITETIT	9
1.1. Informaliteti i vullnetshëm dhe i pavullnetshëm.....	9
1.2. Shkaqet e informalitetit	10
1.3. Qasja ndaj informalitetit.....	10
2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	12
2.1. Hulumtimi Sekondar	12
2.2. Anketa	12
2.3. Rastet e studimit.....	13
3. REZULTATET E ANKETËS: Pasqyra e përgjithshme	14
4. REZULTATET E ANKETËS: Informaliteti në Kosovë	15
4.1. Evazoni fiskal në Kosovë	15
4.1.1. Morali fiskal dhe justifikimi i evazionit fiskal.....	17
4.1.2. Një kërkim empirik.....	18
4.2. Informaliteti në fuqinë punëtore në Kosovë	21
4.2.1. Ligji i punës.....	23
5. RASTET E STUDIMIT	25
5.1 Femrat, viktimë e ligjit të punës	25
5.2 Mijëra punëtorë pa kontrata.....	27
5.3 Ngecje në luftimin e informalitetit.....	28
6. KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET	31
7. REFERENCAT	33

PARATHËNIE

Informaliteti është një fenomen global mjaft i përhapur, i cili është bërë tipar i shteteve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Pavarësisht nga shtrirja globale, dhe pavarësisht nga efektet negative që ka, informaliteti prapë mbetet term që shkakton shumë mosmarrëveshje, të cilat drejtpërdrejt lidhen me definicionin e tij, klasifikimin dhe matjen. Ky studim ka për qëllim të prezantojë pamjen reale të informalitetit në Kosovë; madhësinë, përcaktuesit, dhe pasojat ekonomike që ky fenomen mund t'i shkaktojë.

Në këtë studim, informaliteti definohet si fenomen që përshkruan të gjitha aktivitetet ekonomike të cilat zhvillohen fshehurazi nga shteti, dhe të cilat nuk i neglizhojnë rregullat e shtetit. Si i tillë, ky përfshinë konceptet si evazionin fiskal, punësimin jo-formal dhe nën-deklarimi i pagave të punëtorëve.

Ballafaqimi me problemin që e shkakton informaliteti dhe gjetja e zgjedhjeve për këtë çështje, ka rëndësi të madhe nëse shikohet nga perspektiva ekonomike dhe socio-politike. Në përgjithësi, informaliteti shkakton disa kosto ekonomike mbi shtetin, duke e vendosur stabilitetin shoqëror në rrezik; e zvogëlon rritjen ekonomike, duke e dobësuar aftësinë e qeverisë të ofrojë të mira shoqërore për qytetarët; ofron motiv për firma të vogla që të mbesin të tilla dhe të vazhdojnë të facilitojnë evazionin (në taksë apo në fuqi punëtore), duke e humbur kështu mundësinë e krijimit të vendeve të reja të punës në ekonominë formale, dhe, gjithashtu, duke gjeneruar jo-barazi në mes të atyre që bëjnë evazion dhe atyre që paguajnë (barra bie tek të fundit), gjë që krijon motiv shtesë për involvim në evazion. Në fund, informaliteti shpie në konkurrencë jo fer, dhe vendosë barrë më të madhe në bizneset formale. Gjithashtu, duhet të merret parasysh natyra e pa sigurtë e punësimit jo-formal, e cila ka implikime në zhvillimin ekonomik të punëtorit. Punëtorët në punë jo-formale janë të nën-punësuar, për faktin se shumica e tyre punojnë shumë më tepër orë vetëm për ta arritur pagën minimale. Së dyti, këta punëtorë nuk kanë benefite nga pensionet apo sigurimi shëndetësor, për shkak të pagave të nën-deklaruara; një fakt i cili në periudha afatgjate e ngritë koston sociale për shtetin. Së treti, sektori jo-formal mund të rezultojë në dis-balanc gjinor. Së fundi, shqetësime janë ngritur lidhur me ligjin e ri të punës, i cili ka rezultuar në efekte negative lidhur me pushimin e lehonisë. Me sa duket, përveç se është bërë e vështirë për gratë të marrin kontrata afatgjate, është rritur risku i grave që të jenë të mbi-representuara në sektorin jo-formal.

Ka shumë studime për informalitetin si fenomen, për implikimet që ka në punësimin jo-formal dhe për implikimet e përgjithshme në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, megjithatë, ky është studimi i parë që e ka për fokus Kosovën. Si i tillë, ky studim do të ju ofrojë politik-bërësve të Kosovës një bazë, e cila mund të përdoret për të zhvilluar iniciativa politike efektive dhe propozime se si të adresohet ky problem, i cili ndikon në mirëqenien e popullit.

Brenda këtij studimi, disa aspekte të cilat kanë pasur efekt në sektorin jo-formal do të identifikohen, duke marrë parasysh ligjin e ri të punës. Për më tepër, do të zbulohen lidhjet në mes të disa politikave, ligjeve, dhe rregulloreve në njërin anë dhe punësimit jo-formal dhe evazionit fiskal në anën tjetër, duke çuar kështu te konkluzione të reja, që si të tilla ndihmojnë zhvillimin e strategjive të reja, për t'u ballafaquar me problemet që shkakton ekonomia jo-formale. Prandaj, zbulimet mund të shfrytëzohen nga parlamenti dhe komisionet parlamentare, si dhe nga ministritë të cilat do të kenë rastin të inkorporojnë rezultatet e këtij studimi në politikat e tyre. Kjo mund të ju ndihmojë politik-bërësve të gjejnë zgjedhje dhe të zhvillojnë klimën e bizneseve, të inkurajojnë investimet e huaja dhe të avancojnë pozitën e punëtorëve.

Ky studim, gjithashtu, ka për qëllim të ngjallë diskutim me qëllim të vetëdijesimit të popullatës rreth të kuptuarit të problemeve që sjell informaliteti. Në përgjithësi, studimi ka potencial jo vetëm të ndikojë në zhvillim ekonomik, por, gjithashtu, të shtrojë një agjendë socio-politike, e cila do të jetë në dobi të qytetarëve të Kosovës.

Studimi organizohet në këtë mënyrë. Kapitulli i parë do t'i ofrojë lexuesit njohuri të përgjithshme për debatin akademik në këtë temë. Ky kapitull do ta shpjegojë origjinën e konceptit dhe do të paraqes definicionet e rëndësishme të informalitetit. Kapitulli i dytë do të ofrojë njohuri të përgjithshme për metodologjinë e këtij studimi. Për më tepër, do të shpjegohet qasja e këtij studimi. Kapitulli i katërt dhe pestë, do të analizojnë dhe interpretojnë rezultatet e hulumtimit — kjo përfshinë zbulimet nga pyetësi dhe rastet e studimit. Në fund, studimi do të konkludohet me një përmbledhje të implikimeve kryesore të këtij studimi, dhe do të ofrojë rekomandime.

GJETJET KRYESORE TË HULUMTIMIT

Pjesa në vazhdim përmbledhë gjetjet kryesore të pyetësorit, i cili është zhvilluar me 600 biznese në Kosovë në fushën e informalitetit (në evazion fiskal dhe nën-deklarim të punëtorëve) në Kosovë.

GJETJET KRYESORE PËR EVAZIONIN FISKAL

- Konkurrenca jo fer (që rrjedh nga evazoni fiskal dhe nën-deklarimi i punëtorëve) është përmendur si barrierë më e lartë në të bërit biznes (nga një liste prej 22 barrierash) nga të intervistuarit. Krahasuar me studimet paraprake, të cilat vlerësojnë barrierat e të bërit biznes, intensiteti i këtij perceptimi është rritur, gjë që tregon se konkurrenca jo fer në të bërit biznes në Kosovë është problem shumë serioz.
- Sipas të dhënave nga pyetësi, menaxherët dhe pronarët e bizneseve besojnë se mesatarisht bizneset në industrinë e tyre raportojnë rreth 65.6 përqind të shitjeve, që do të thotë se 34.4 përqind të shitjeve nuk deklarohen. Bizneset janë kontribuues të mëdhenj të buxhetit të shtetit; nëse shitjet nuk deklarohen do të thotë që të mirat dhe shërbimet të cilat shteti ju ofron qytetarëve nga kontributet e bizneseve janë më tepër se për një të tretën më të ulëta sesa që mund të jenë.
- Secili nga shtatë rajonet e Kosovës është analizuar sa i përket evazionit fiskal dhe shitjeve. Rajoni i Gjilanit paraqitet si rajoni me evazionin më të lartë të taksave (me 59.9 përqind të shitjeve të pa deklaruara), ndërsa rajoni më së paku evaziv është ai i Gjakovës (me vetëm 20.2 përqind të shitjeve të pa deklaruara).
- Lidhur me intensitetin e auditimeve të taksave, 37.3 përqind të respondentëve besojnë që ekziston mundësia e lartë apo shumë e lartë të zihen duke i ikur taksave. Megjithatë, 62.7 përqind të respondentëve besojnë se, nëse ata vendosin t'i ikin taksave, ata mund të bëjnë këtë gjë shumë lehtë, pa u zënë nga autoritetet.
- Në mesatare, 42.4 përqind të respondentëve besojnë që niveli i gjobave është i lartë apo shumë i lartë. Përderisa një nivel më i lartë i taksave mund të shpie në nivel më të lartë të deklarimeve, ajo mund të ketë edhe efekt negativ nëse bizneset e perceptojnë një taksë më të lartë si jo të drejtë.

- Rreth 9 përqind të respondentëve gjithmonë do ta justifikonin evazionin fiskal. Kur kjo vlerë krahasohet me World Value Survey, Kosova rangohet në nivel të njëjtë si India (8.9 përqind) dhe Brazili (8.6 përqind).
- Duke marrë parasysh nivelin e shërbimeve publike të ofruara, respondentët besojnë që ata duhet të paguajnë 60 përqind më pak taksë sesa që ata paguajnë tani.
- Në një rast hipotetik, nëse ka rritje të taksës për 10 pikë përqindje, 78 përqind të respondentëve kanë treguar gatishmëri t'i ikin taksave. Shkalla e evazionit potencial rritet në 82.5 përqind nëse taksat rriten për 20 pikë përqindje shtesë.

GJETJET KRYESORE TË INFORMALITETIT PËR FUQINË PUNËTORE

- Menaxherët dhe pronarët e intervistuar besojnë se bizneset në industrinë e tyre respektive raportojnë në mesatare 63 përqind të punëtorëve të tyre. Kjo do të thotë që në mesatare 37 përqind të fuqisë totale punëtore nuk raportohet.
- Për më tepër, rezultatet e pyetësorit zbulojnë që informaliteti në fuqi punëtore ndryshon ndër sektorë; megjithatë, ashtu siç thotë literatura, bujqësia është sektori ku fuqia punëtore deklarohet më së paku dhe ku vetëm 30 përqind e fuqisë punëtore deklarohen. Mbi 60 përqind të popullsisë së Kosovës varen nga bujqësia, përderisa 70 përqind të fuqisë punëtore mbetet e nën-dekluar në atë sektor. Sektori me numrin më të lartë të deklarimit të punëtorëve është sektori i edukimit me vetëm 17.5 përqind evazion.
- Kur respondentët janë pyetur se a janë në dijeni për ligjin e ri të punës, 41.2 përqind të respondentëve kanë deklaruar që ata nuk ishin të informuar apo nuk kishin njohuri për të. Një anë pozitive është se 73.3 përqind e respondentëve ishin në dijeni për pagën minimale.
- Lidhur me pushimin e lehonisë, 37 përqind të respondentëve rekomandojnë ndryshime në mënyrën e pagesës së pushimit. Sugjerimi më i shpeshtë është të ndryshohet pagesa e pushimit të lindjes në mënyrë që gjashtë muajt e parë të paguhen nga buxheti i shtetit, ndërsa muajt e mbetur të paguhen nga punëdhënësi.

1. DEFINICIONI I INFORMALITETIT

Koncepti i informalitetit është kompleks dhe ka nxitur debat të thellë dhe kontravertz në akademi. Për shkak të kompleksitetit, definicioni i konceptit ndryshon shumë dhe nuk ka konsensus se çka realisht kuptojmë me informalitet. Prandaj, ky seksion do të jap një përmbledhje të definicioneve dhe qasjeve të ndryshme lidhur me informalitetin dhe pastaj do të përshkruajë informalitetin në formën, siç paraqitet në këtë raport.

Termi “informalitet” për herë të parë është përdorur në vitin 1970 për të përshkruar aktivitetet ekonomike që zhvilloheshin jashtë rregullit shtetëror. Megjithatë, fenomeni social i punësimit jo-formal ekzistonte edhe më herët. Edhe pse marrëdhëniet e punës jo-formale nuk janë kritikuar në atë kohë, kishte disa hulumtues social të cilët – në raportet e tyre – shkruanin për aktivitetet ekonomike jo-formale, duke përmendur, për shembull, zbatimet e rrugës, tregtarët, apo punëtorët nëpër disa fabrika.

Dualizmi që ndan aktivitetet ekonomike formale dhe jo-formale nuk u bë temë debati, derisa Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) publikoi një raport për tregun e punës në vitin 1972, në Kenia. Misioni Kenia (ONP 1972) rezultoi në disa vërtetime për karakteristikat e punësimit jo-formal (Bangasser 2000) dhe ngriti vetëdijen në komunitetin shkencor rreth rëndësisë së tij për zhvillimin socio-ekonomik. Është interesant që raporti “Misioni Kenia” përmendi sektorin jo-formal si fenomen pozitiv, edhe pse kritikoi pagat e ulëta që paguheshin. Duhet të theksohet që përderisa ky raport përmend aspektet pozitive të tregut të punës jo-formale, ka shumë arsye që informaliteti të konsiderohet fenomen që pengon zhvillimin ekonomik, prandaj duhet të luftohet.

Shqyrtimi i literaturës së fundit, që mundohet ta definojë informalitetin, na sjell tek pyetja e shpeshtë se a duhet ky koncept të përfshijë të dyja aktivitetet, ato “ligjore” dhe “jo-ligjore”. Aktivitetet ligjore përfshijnë aktivitetet biznesore të përgjithshme, të cilat kur zihen mund të formalizohen (pasi ta marrin dënimin), por nuk shuhen; p.sh. këto aktivitete mund të sjellin të ardhura shtesë në buxhet. Aktivitetet jo-ligjore, në anën tjetër, përfshijnë aktivitetet të cilat nuk duhet ekzistuar; si trafikimi i qenieve njerëzore apo i drogës. Këto aktivitete, kur zihen, pushojnë së ekzistuari dhe nuk sjellin të hyra shtesë në buxhet.

Smith (1994), për shembull, përfshinë të dyja llojet e aktiviteteve në definicionin e tij të ekonomisë në hije. Sipas tij (p.18), defini-

cioni përfshinë “prodhimet e mallrave apo shërbimeve nga tregu, qoftë të ligjshme apo paligjshme, të cilat nuk përfshihen në matjet zyrtare të BPV-së”. Edhe pse ky definicion është gjithëpërfshirës dhe – të paktën në shikim të parë – është ideal, shumica e autorëve thonë që përderisa në një definicion më të gjerë aktivitetet ilegale janë pjesë e ekonomisë në hije, një ndarje në mes të prodhimit ligjor dhe jo-ligjor brenda sektorit është esenciale, në mënyrë që jo vetëm të lehtësojë matjen e këtyre aktiviteteve, por edhe të bëjë që figurat që nxirren nga ky hulumtim të jenë më precize dhe më të besueshme. Kjo kritikë është definitivisht valide, prandaj ky punim zgjedh një kornizë konceptuale më të ngushtë. Një prej tyre ofrohet nga Friedrich Schneider (2012), për shembull, që definon ekonominë në hije si “të gjithë prodhimin ligjor të tregut të mallrave dhe shërbimeve, që me qëllim fshihet nga autoritetet publike”, në këtë mënyrë duke lënë jashtë të ashtuquajturat “aktivitetet nëntokësore”, që përfshijnë aktivitetet jo-ligjore dhe shërbimet, si dhe prodhimin e amvisërive.

Një kornizë konceptuale më precize dhe e sofistikuar është krijuar nga Bernabè (2002). Brenda konceptit të informalitetit, ajo (p. 5) propozon këto katër nën-kategori: (a) Aktivitetet informale, që bëhen për të ‘kënaqur nevojat themelore’; (b) aktivitetet e “ndërtokës”, që fshihen qëllimisht nga autoritetet publike për t’u shmangur pagesës së taksave ose përputhshmërisë me rregullat; (c) aktivitetet ilegale, që prodhojnë mallra dhe shërbime të ndaluara me ligj ose që nuk janë të ligjshme të prodhohen nga prodhuesit e paautorizuar; dhe (d) aktivitetet e amvisërive, që prodhojnë për konsum vetanak. Kategorizimi i saj është relevant për këtë punim, pasi që hulumtimi i saj poashtu merret me informalitetin në vendet në tranzicion, prandaj mund të jetë i aplikueshëm edhe për Kosovën. Me këtë definicion, ky studim mundet ta mat (a) dhe (b).

1.1 INFORMALITETI I VULLNETSHËM DHE I PAVULLNETSHËM

Një pjesë e madhe e literaturës rreth informalitetit shpjegon shkaqet e këtij fenomeni të shpërndarë jo vetëm në shtetet e zhvilluara, por edhe në shtetet në zhvillim apo në tranzicion (Gërxhani 1999, OECD 2004, Simons and Lake 2006, Bernabè 2008, Kucera and Roncolato 2008, Kanbur 2009, Ordóñez 2010, Lehmann and Muravyev 2012, Schneider 2012).

Siç e përmendin shumë autorë, është e rëndësishme për tu

kuptuar nëse punëtorët marrin punë informale sepse *ju duhet* apo sepse *duan* (Ruffer and Knight 2007). Sipas Ruffer dhe Knight (2007), ka dy qëndrime të kundërta rreth tregjeve informale të punës. Së pari, sipas një vështrimi, sektori informal më së shumti i shërben funksionit të absorbimit të tepicës së fuqisë punëtore. Rrjedhimisht, rritja e informalitetit interpretohet si i imponuar për individin. Mbështetësit e perspektives tjetër insistojnë që sektori informal duhet të shihet si sektor dinamik që i ndihmon zhvillimit ekonomik. Në këtë rast rritja e këtij sektori shihet si shenjë e suksesit ekonomik dhe punësimi informal zgjidhet me vullnetin si mundësi për profit më të lartë. Sipas autorëve, të dy qëndrimet mund të jenë të sakta dhe mund të aplikohen në shtetin e njëjtë. Dallimi i njëjtë vërehet edhe nga Kucera dhe Roncolato (2008), të cilët koncentrohen në faktin se ka diferencë të dallueshme në mes të punësimit informal të vullnetshëm dhe të pavullnetshëm. Siç thonë këta, dallimi varet nga stazhi i zhvillimit të shtetit. Sipas tyre, shtetet e zhvilluara kanë siguri më të mëdha sociale dhe “kështu papunësia e hapur mund të jetë alternativa më e mirë sesa punësimi informal i pavullnetshëm në rast të humbjes së vendit të punës” (Kucera dhe Roncolato 2008).

Në anën tjetër, papunësia në vendet më pak të zhvilluara rrit varfërinë aq sa punëtorët në këto shtete thjeshtë nuk mundën me mbetë të papunë, dhe rrjedhimisht duhet të pranojnë punësim në sektorin informal (Kucera dhe Roncolato 2008). Një qëndrim i ngjashëm jepet nga Bernabè (2002) dhe Rutkowski (2006). Ata thonë se, për ekonominë në tranzicion, motivimi për punë në ekonominë e hirtë vjen nga mungesa e mundësive formale dhe nevoja për mbijetesë. Bernabè (2008, p. 5) — duke ju referuar specifikisht vendeve në tranzicion — në anën tjetër thotë se “[aktivitetet e “nëntokës” në vendet e zhvilluara] fshihen qëllimisht nga autoritetet publike” në mënyrë që tu shmangen taksave dhe/apo ndonjë qëllim tjetër jo të ligjshëm. Përderisa në këtë studim ne nuk do të përqendrohemi në këtë dallim, ne e vlerësojmë rëndësinë e këtij dallimi, dhe do të mundohemi të shpjegojmë motivim e njerëzve për punësim në sektorin informal përmes rasteve të studimit të dhënave tjera.

1.2 SHKAQET E INFORMALITETIT

Sado e gjerë të jetë literatura e informalitetit, aq janë edhe faktorët që janë identifikuar si përcaktues për vendimin e punëtorit apo punëdhënësit për të vepruar në ekonominë e hirtë. Së pari, ka një numër autorësh që sugjerojnë që niveli i taksave, si dhe barrierat që lidhen me burokraci dhe rregullimet e punësimit, luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në përcaktimin e bizneseve të operojnë jo-formalisht (Demirgüç-Kunt, Klapper dhe Panos 2009: 10; shih poashtu De Soto 1989, OECD 2004, Chen 2004, Feld dhe Frey 2007, Lehmann dhe Muravyev 2012). Bazuar në kërkim empirik, Lehmann dhe Muravyev (2012), për shembull, vijnë në përfundim që rregulloret

e punësimit dhe barra e tatimit kanë efektin më të madh në madhësinë e sektorit informal të një shteti.

Duke mos lënë anash tatimet dhe barrën e rregulloreve, Schneider (2007), si barriera kyçe, shton edhe rënien e cilësisë dhe sasisë së mallrave dhe shërbimeve publike, korrupsionin e zyrtarëve publik dhe trajtimin jo të mirë të taksapaguesve nga autoritetet tatimore. Ngjashëm, Gërzhani (1999) vëren se motivimi për punësim jo-formal mund të ketë shkaqe ekonomike dhe jo-ekonomike, të cilat janë: zhvillimi jo i mjaftueshëm ekonomik, barra e madhe tatimore dhe sistemi i tatimit i komplikuar, korniza ligjore institucionale dhe ligjore e komplikuar dhe e dobët, mekanizmat jo-efiçent të përforcimit, niveli i lartë i korrupsionit dhe jo-kompetenca burokratike nga agjentët qeveritar, mungesa e besimit në institucionet shtetërore, qasja “laissez-passer” ndaj sektorit informal, luftërat civile në disa prej këtyre shteteve, dhe “konflikti në mes të normave të krijuara ekonomike dhe sociale në të kaluarën dhe reagimi ndaj realitetit të ri në të tashmen” (Gërzhani 1999, p. 15).

Shkalla e informalitetit varet edhe nga niveli i aftësive dhe demografia. Niveli i aftësive matet me shkollimin ose angazhimin në industri. Intuitivisht, ne presim që fuqia punëtore me aftësi të ulëta të veprojnë më shumë jo-formalisht duke konsideruar kompensimin dhe faktorët tjerë. Studimet mbështesin këtë fakt; për shembull, Hazans (2011), në hulumtimin e tij për shkallën e informalitetit në Evropë, gjen se “mesatarja e përgjithshme [shkalla e informalitetit] është 14.5 përqind për punëtorët me aftësi të ulëta, 8.4 përqind për ata me aftësi mesatare, dhe 5.7 përqind për ata me aftësi të larta”.

1.3 QASJA NDAJ INFORMALITETIT

Përderisa akademikët koncentrohen shumë në krijimin e kornizës konceptuale për matjen e informalitetit, ka studime që fokusohen në sfidat më praktike që krijohen nga informaliteti. Prapë, ka një ndarje në mes të autorëve që shohin informalitetin si pengesë që duhet eliminuar sa më shpejt, dhe tjerëve, që thonë se informaliteti përbën një fenomen që mund të përdoret për rritje ekonomike në aspekt afatgjatë. Këta të fundit, informalitetin e konsiderojnë si diçka që mundet jo vetëm ta mbrojë ekonominë nga rënia e plotë duke krijuar mundësi pune, por edhe si diçka që ofron të ardhura për ata që përndryshe do të ishin të papunë. Rrjedhimisht, disa studiues avokojnë që politikë-bërësit të koncentrohen në gjetjen e mënyrave që gradualisht të inkorporojnë sektorin jo-formal në atë formal, sesa që ta eliminojnë atë. Nazia Habib-Mintz (2008), për shembull, është avokuese e këtij qëndrimi. Ajo kërkon që politikat të koncentrohen të përmirësojnë njësitë prodhuese, dhe merr shembull Kinën dhe Indinë si shtete që janë zhvilluar ekonomikisht përkundër sektorit të madh informal. Megjithatë, duket të ketë konsensus të gjerë që shumë mangësi ekzistojnë për ekonominë si dhe individët të involvuar në informalitet në fuqinë punëtore.

Ruffer dhe Knight (2007) ofrojnë një vështrim më të balancuar mbi informalitetin. Ata thonë se dy konflikte të mëdha janë ngritur. Derisa ka njerëz që e shohin formalizimin si prioritet, tjerët sugjerojnë që politikat duhet të lidhen me përmirësimin e mirëqenies së njerëzve të punësuar në sektorin informal. Siç e potencojnë me të drejtë autorët, kjo i le politikë-bërësit me një sfidë të madhe; duhet të bëjnë politika që, në një anë, ndihmojnë të përmirësojnë jetën e të varfërve, dhe, në anën

tjetër, të sigurohen që stimulimi për formalizim të mos zhduket.

Pasi që ky studim merr parasysh pikë-vështrimin që informaliteti është i dëmshëm për zhvillimin socio-ekonomik të vendit, dhe duke pasur parasysh shtrirjen e limituar, nuk do të merret shumë me benefitet potenciale nga formalizimi. Sidoqoftë, bazuar në gjetjet empirike, do të formulohen disa rekomandime të vlefshme për politikat në këtë drejtim.

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Fillimisht, ky studim, sa më saktë që është e mundur, mundohet ta vlerësojë nivelin e informalitetit në Kosovë, që përfshinë aktivitetet e padeklaruara ligjore, por nuk përfshinë aktivitetet jo-ligjore. Për më shumë, ky studim poashtu tenton ta përcaktojë informalitetin dhe faktorët si: karakteristikat e firmës dhe industrisë, madhësinë e industrisë, barrierat institucionale ose ambientin e përgjithshëm biznesor. Në mënyrë që të mat shtrirjen e aktiviteteve informale në Kosovë, ky studim përdor hulumtim primar, sekondar dhe raste studime. Duke pasur parasysh natyrën e vështirë të vrojtueshme të informalitetit, studiuesit qenë dashur të bazohen në metoda alternative, nganjëherë kreative, të *matjes së informalitetit*. Literatura e përgjithshme për informalitetin njih dy metoda më të përdorura. E para, metoda indirekte, përpiket të mat shkallën e informalitetit me të dhëna të grumbulluara. E dyta, metoda direkte, bazohet në anketë – kryesisht e dizajnuar me pyetje indirekte. Përpjekja për të kuptuar përcaktuesit e informalitetit që lidhen me rastet individuale ka favorizuar metodën direkte – pyetjet indirekte – kundrejt kuptimit të nivelit të sektorit informal përmes metodës indirekte. Duke dizajnuar pyetësor që kapin jo vetëm sjelljen informale po edhe karakteristikat individuale të *jo-formalistëve*, anketat u bënë mjeti kryesor i studiuesve. Anketat, megjithatë, janë shpesh subjektive. Sipas Gerxhani (2002), individët shpesh nuk kanë stimulim për t'u përgjigjur sinqerisht, duke i bërë rezultat të njëanshme, pra duke treguar numra më të vegjël të informalitetit sesa ata real. Është e rëndësishme të thuhet që ky studim do të fokusohet në perspektivën e punëdhënësve (përmes anketës). Poashtu, përmes një numri të rasteve të studimit, do të përpiket të paktën të hedh dritë në perspektivën e punëtorit. Edhe pse jo të fokusuar në faktorët që i shtojnë punëtorët në fuqinë punëtore informale – duke supozuar që shumë prej tyre bëjnë këtë pavullnetshëm – është dukur e rëndësishme për hulumtuesit të shfaqin aspekte të “realitetit të punës” të këtyre punëtorëve.

Pjesa tjetër e këtij kapitulli shqyrton mjete që janë aplikuar në këtë hulumtim për të vrojtuar dhe kapur disa karakteristika të informalitetit në Kosovë.

2.1. HULUMTIMI SEKONДАР

Përmes hulumtimit sekondar, hulumtuesit u familjarizuan me informalitetin dhe kompleksitetin e tij si fenomen. Literatura e shqyrtuar, në hap të parë, përfshin punimet akade-

mike, raportet e Institucioneve si Banka Botërore dhe FMN, dhe Institucione tjera statistikore. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të definohej fokusi i punimit, që për qëllimin tonë përfshin vetëm aktivitetet ligjore të padeklaruara. Për shkak të natyrës së ndejshme të temës shumë studime fokusohen në metodologjinë e zhvillimit të pyetësorëve për studime që mbështeten në sinqeritetin e të anketuarve dhe gatishmërinë e tyre për t'u përgjigjur në pyetje të papërshtatshme. Prandaj, një pjesë e madhe e hulumtimit sekondar është koncentruar në analizën e anketës dhe dizajnin e pyetjeve në mënyrë që të nxirren informata të rëndësishme nga të anketuarit për qëllimet e këtij studimi. Më shumë se gjashtë anketa¹ relevante janë analizuar, përveç analizës tjetër që është bërë specifikisht për rastin e Kosovës. Dizajnimi i pyetësorëve optimal ishte qëllimi kritik i hulumtimit sekondar.

2.2. ANKETA

Të dhënat e llogaritshme janë mbledhur përmes anketës me 600 biznese në Kosovë, të cilat janë zgjedhur nga baza e të dhënave e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), në intervalin e besueshmërisë 99 përqind. Kjo mostër është statistikisht reprezentative e numrit të bizneseve të regjistruara në Kosovë. Pasi që ky studim nuk ka për qëllim të fokusohet në një sektor specifik, është zgjedhur një grup i gjerë i bizneseve me metodën e rastësishme. Kjo iu ka mundësuar hulumtuesve të identifikojnë sektorët në të cilët aktivitetet informale janë më të theksuara. Prandaj, për konceptualizimin e anketës, është parë e rëndësishme të përfshihen pyetje për perceptimin e pronarëve të bizneseve rreth politikave që kanë të bëjnë me rregullimet tatimore dhe punësimin, si dhe praktikat biznesore të tyre dhe konkurrencës (pjesa e dytë e anketës). Poashtu, ishte esenciale të përfshiheshin pyetje bazike rreth biznesit (pjesa e parë e anketës), të cilat mundësojnë të shfaqen trendet që ekzistojnë në mes të karakteristikave të firmës dhe praktikave të biznesit.

Para se të lëshohej anketa në terren për t'u implementuar plotësisht, u bë një test me 50 biznese për të parë nëse pyetësori kishte “defekte” të dukshme apo nëse pyetje të caktuara kishin

1 UNDP Raporti i Zhvillimit Njerëzor Pyetësori; Zyra Ndërkombëtare e Punës Pyetësori; EBRD Ambienti Biznesor dhe Performanca e Ndërmarrjeve Pyetësori

nevojë të modifikoheshin. Anketa u bë vetëm me pronarë apo menaxherë të bizneseve, të cilët janë të informuar dhe kanë leje të flasin rreth pikë-vështrimeve dhe/apo eksperiencave rreth përputhshmërisë së kompanisë së tyre me rregullimet tatimore dhe të punës. Në bazë të perceptimit të tyre subjektiv, atyre u dha mundësia të komentojnë direkt rreth praktikave biznesore të konkurrentëve të tyre dhe rreth barrierave me të cilat përballen sektorët e tyre në Kosovë.

2.3. RASTET E STUDIMIT

Në mënyrë që të prezantohet një pasqyrë sa më gjithëpërfshirëse e madhësisë dhe arsyeve të informalitetit në Kosovë, dhe për të kuptuar fytyrën e vërtetë të këtij fenomeni shumë kompleks, janë bërë katër raste studimi gazetareske. Për këtë angazhim, një gazetar nga e përditshmja 'Zëri', gjeti tri raste reale në Kosovë, të cilat janë përballur me aktivitete informale

dhe kanë folur për rastin e tyre. Rastet e studimit ia shtojnë vlerën anketës, duke pasur parasysh që është e vështirë për rastet e studimit të japin një pasqyrë reale të kësaj teme të ndjeshme. Qëllimi i këtyre rasteve të studimit ishte të mbyllet ndonjë vrimë informacioni që mbetet pas përfundimit të anketës. Për këtë, intervistat paraqesin edhe pikë-vështrimet në temat e deklarimit të punëtorëve, evazionit fiskal, efektet e ligjit të punës dhe ryshfetit.

Rastet e studimit depërtojnë në ekonomi të hirtë, duke përfshirë kushtet e punës me të cilat punëtorët informal duhet të merren çdo ditë. Temat e rasteve të studimit janë zgjedhur nga ekipi hulumtues, pas vrojtimit të rezultateve të anketës, përderisa gazetari kërkoi rastet të cilat ju përgjigjeshin këtyre temave. Anonimitet i plotë është garantuar në të gjitha rastet, përveç kur folësi vullnetarisht ka zgjedhur që t'i zbulohet identiteti. Këto njohuri që nxirren nga rastet do të ndikojnë konsiderueshëm në rekomandimet për politika që nxirren në fund të studimit.

3. REZULTATET E ANKETËS:

Pasqyra e përgjithshme

Ky seksion do të jap një pasqyrë të përgjithshme të pyetjeve themelore (screening) nga anketa, në mënyrë që të jepet profil përshkrues i bizneseve që janë subjekt i këtij studimi. Në mënyrë që të fitohen rezultate kredibile nga anketa, ekipi anketues anketoi vetëm pronarët ose menaxherët ekzekutiv. Kjo u mundësoi hulumtuesve tanë për të marrë informacione më precize për gjendjen aktuale të bizneseve në Kosovë. Kredibiliteti i të anketuarve shton edhe siguri në vlerësimin e pyetjeve të ndjeshme, si për shembull në vlerësimin pyetjeve lidhur me evazionin fiskal dhe informalitetin në fuqinë punëtore. Pikat në vazhdim japin disa karakteristika të firmave të anketuara:

- Duke marr parasysh natyrën e mostrës në fazën para-intervistës, shumica e bizneseve për qëllimin e studimit tonë janë me pronar të vetëm; rreth 87 përqind. Rreth 10.5 përqind e bizneseve të anketuara janë partneritete, derisa 1.3 përqind janë korporata; pjesa tjetër 1.2 përqind bien në kategorinë “tjera”. Kjo shpërndarje garanton kredibilitetin e implementimit të anketës, si dhe përfaqësimin statistikor.
- Rezultatet e anketës poashtu tregojnë që shumica e firmave të intervistuar janë formuar gjatë periudhës para pavarësisë; rreth 64.8 përqind e të gjitha

firmave kanë filluar operacionet gjatë 2000-2007. Është interesant të shihet se prej 2008 deri sot janë formuar rreth 17.7 përqind e firmave të anketuara – një përqindje e ngjashme me periudhën 1968-1999.

- Për më tepër, rreth 30 përqind e të anketuarve thonë që ishin të papunë para së të ndërmerrnin aktivitetin biznesor. Shumica e pronarëve, rreth 38.5 përqind, ishin të punësuar më herët në sektorin privat. Rreth 11.2 përqind ishin student; derisa pjesa tjetër 17.7 përqind ishin të punësuar në sektorin publik.
- Karakteristikat individuale të pronarëve, të shfaqura përmes anketës, tregojnë se 91.8 përqind e bizneseve kanë pronar meshkuj, përderisa vetëm 8.2 përqind kanë pronare femra ndërmarrëse. Prapë, shumica e pronarëve kanë edukim sekondar (54 përqind) dhe fakultet (33 përqind). Rreth 13 përqind e pronarëve kanë vetëm edukim primar. Ne gjejmë se mosha mesatare e pronarëve të bizneseve në Kosovë është 42 vjeç.
- Vetëm 14 përqind e bizneseve të intervistuar thonë që nuk janë anëtare të ndonjë asociacioni të bizneseve në Kosovë.

4. REZULTATET E ANKETËS:

Informaliteti në Kosovë

Një studim i vitit 2011 nga Riinvest-i dhe UNDP-ja tregon që bizneset kosovare perceptojnë konkurrencën jo-fer – të shtyrë nga evazion fiskal dhe informaliteti – si barrierën më të rendë në listën e 22 barrierave tjera. Kjo ishte hera e parë që “konkurrenca jo-fer” doli në majë të listës së barrierave, pas një grupi studimesh viteve të kaluara që listuan korrupsionin dhe/apo furnizimin me rrymë si barrierën kryesore në biznes.

Ky rezultat konfirmohet edhe nga ky studim (kjo anketë). Të anketuarit (për herë të dytë me radhë) e konsideruan “konkurrencën jo-fer”, të shtyrë nga evazoni fiskal dhe informaliteti, si barrierën kryesore në të bërit biznes. Për më tepër, përgjigjet e anketës tregojnë që padrejtësia e perceptuar është rritur konsiderueshëm në intensitet, krahasuar me vitin me vitin e kaluar, nga 76 në 84 përqind të të anketuarve. Këto gjetje sugjerojnë që informaliteti në Kosovë nuk është vetëm problem serioz, por një problem në rritje – kështu që meriton veprim të menjëhershëm për t’u trajtuar (për më shumë rreth barrierave në biznes në Kosovë të nxjerra nga ky studim, vizitoni: www.riinvestinstitute.org).

Në këtë studim në analizojmë dy lloje të informalitetit, evazionin fiskal dhe informalitetin në fuqinë punëtore. Këtë e realizojmë duke i shtruar dy pyetje që kërkojnë nga të anketuarit të tregojnë perceptimin e tyre lidhur me nivelin e shitjeve që deklarohen (evazionin fiskal) dhe numrin e punëtorëve të deklaruar (informalitetin në fuqinë punëtore) në firmat e ngjashme. Ky seksion dhe ai që pason do të na japin një pasqyrë të përgjithshme të nivelit të evazionit fiskal dhe informalitetit në fuqinë punëtore në Kosovë.

4.1 EVAZIONI FISKAL NË KOSOVË

Kjo pyetje është bërë për të matur nivelin e evazionit fiskal në Kosovë:

Q.18 Sa përqind e shitjeve deklarohen tek autoritetet tatimore nga një firmë tipike në fushën tuaj të aktivitetit, duke pasur parasysh vështirësitë e përputhshmërisë me taksat dhe rregulloret tjera?

Të anketuarve u është kërkuar të japin një përgjigje të vetme për proporcionin e shitjeve të raportuara tek autoritetet, të shprehur si përqindje. Përgjigjja jep shkallën e përputhshmërisë me taksat, që pastaj zbritet nga 100, për të gjetur nivelin e evazionit fiskal. Mesatarja e të gjitha përgjigjeve, përfundimisht, jep nivelin shtetëror të evazionit fiskal. Kuptohet, kjo nuk është matje direkte e evazionit fiskal; megjithatë, në mungesë të programeve të matjes së taksave, studimet që kanë për subjekt ekonominë në tranzicion kanë adaptuar anketat dhe pyetjet indirekte si më të përshtatshmet. Siç është argumentuar në shqyrtim të literaturës, bërja e pyetjeve indirekte rreth aktiviteteve të fshehura, është metoda më e përdorur nga studiuesit.



Menaxherët e bizneseve dhe pronarët besojnë që në mesatare bizneset në industrinë e tyre raportojnë rreth **65.6 përqind** të shitjeve, që nënkupton se **34.4 përqind** u shmangët atyre.


Sipas të dhënave të anketës, menaxherët e bizneseve dhe pronarët besojnë se në mesatare bizneset në industrinë e tyre raportojnë rreth 65.6 përqind të shitjeve të tyre, që nënkupton se 34.4 përqind u shmangen tatimit. Rezultate të ngjashme janë arritur në Raportin e Zhvillimit Njerëzor të UNDP (2012). Raporti gjen se në 2011 rreth 39 përqind të shitjeve nuk janë raportuar nga bizneset. Numrat e tanishëm tregojnë që niveli i evazionit fiskal është ulur sadopak në dy vitet e fundit, sidoqoftë niveli i tanishëm është prapë alarmues. Bizneset janë kontribuues të mëdhenj të buxhetit, dhe kjo nënkupton që shërbimet publike, që do të mund të financoheshin nga kontributet e bizneset, janë për një të tretën më të vogla se që do të mund të ishin.

Një gjetje tjetër, bazuar në madhësinë e firmave, tregon që ka një korrelacion negativ të lartë në mes të evazionit fiskal të supozuar dhe madhësisë së firmës (matur me numrin e punëtorëve – Figura. 1). Rezultatet tregojnë që bizneset e mëdha kanë tendencë t’i shmangen tatimit më pak; përderisa bizneset e vogla tregojnë sjellje më pak konformiste.

Ky korrelacion është në pajtim me pritjet teorike dhe kërkimet e mëhershme empirike në këtë fushë (shih Nur-tegin 2008), duke pasur parasysh prezencën e dy faktorëve të rëndësishëm. Së pari, firmat e mëdha janë më të konsoliduara; rrjedhimisht, kanë më pak arsye për të kërkuar avantazh duke bërë aktivitete të rrezikshme ilegale. Së dyti, duke pasur parasysh resurset e limituara të administratës tatimore, si dhe nevojën për të

Figura 1. Shitjet e pa raportuara për shkak të taksave (të kryqëzuara sipas madhësisë së kompanisë)

■ Evazioni i taksave dhe madhësia e firmës



Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

optimizuar këto resurse në maksimizim të të hyrave tatimore, zyrtarët tatimor targetojnë firmat e mëdha – ku shumica e të hyrave mblidhen. Kjo gjetje, poashtu, do të na ndihmojë të nxjerrim një rekomandim të rëndësishëm lidhur me politikat e strategjisë së auditimit nga ATK-ja, në konkluzion të raportit.

Ndërlidhja negative në mes të madhësisë së biznesit dhe evazionit fiskal vërehet edhe kur shohim ndërlidhjen e shitjeve të raportuara me madhësinë e kompanisë, duke u bazuar në nivelin e shitjeve.

Figura 2, megjithatë, tregon një ndryshim të vogël në skajin e trendit që tregon ndërlidhjen me firmat që qëndrojnë në kategorinë e shitjeve prej 50-100.000 EUR. Kjo mund të jetë indikator i grupit me përputhshmërinë më të madhe fiskale në Kosovë.

Një gjetje tjetër bazuar në dallimet e sektorëve tregon se sektori i “ndërtimit”, pasuar nga “shkollimi” dhe “artet dhe rekreacioni” janë sektorët me përputhshmërinë më të lartë; ndërsa sektorët që më së shumti i shmangen tatimit janë “banimi dhe shërbimet ushqimore”, “industria përpunuese” dhe “bujqësia”. Kjo gjetje nuk është befasuese duke pasur parasysh pritjet që sektorët me transaksione më të mëdha të kesh-it dhe/apo industritë më pak të inspektuara ka më shumë të ngjarë t’u shmangen tatimit, siç del të jetë rasti në ambientin e tanishëm të biznesit në Kosovë.

Shitjet e raportuara për tatim poashtu ndryshojnë në shtatë regjione të Kosovës. Sipas rezultateve të anketës, regjioni i Gjilanit më së shumti u shmangte taksave, me rreth 60 përqind të shitjeve të pa deklaruar tek autoritetet tatimore; pasuar nga

regjioni i Pejës me 45 përqind të shitjeve të shmangura; regjioni i Mitrovicës me 44 përqind evazion; regjioni i Ferizajit me 40 përqind evazion; regjioni i Prizrenit me 33 përqind evazion; dhe regjioni i Prishtinës me 27 përqind evazion. Regjioni i fundit në listë, me përputhshmërinë tatimore më të lartë, është regjioni i Gjakovës, me 20 përqind evazion (shiko Figurën 3).

Karakteristikat rajonale dhe diferencat në shitjet e raportuara, siç shihen në këtë studim, mund të shërbejnë për ta përshtatur strategjinë e auditimit të ATK-së.

Të anketuarit janë pyetur të japin një përshtypje të përgjithshme të frekuencës së auditimit tatimor (inspeksioneve). 37.3 përqind të të anketuarve kanë thënë që kanë gjasa të mëdha apo tepër të mëdha që një biznes të zihet duke ju shmangur tatimit. 62.7 përqind besojnë që lehtë mund t’u shmangen tatimit. Këto perceptime alarmuese rreth auditimit, dhe rrjedhimisht nivelit të dënimeve, ndoshta më së miri pasqyrojnë se si shihen mekanizmat parandalues të inspektoriatit tatimor në Kosovë. Niveli i ulët i “frikës për tu zënë” është një përcaktues i rëndësishëm i sjelljes fiskale, sidomos në perceptimin e rrezikut, që përfundimisht përcakton vendimin e tyre “për të paguar ose jo”.

Poashtu, 42.4 përqind e të anketuarve konsiderojnë nivelin e dënimeve të jetë i lartë, apo tepër i lartë. Momentalisht, duke u bazuar në anketë, është e pamundur të definohet nëse dënimet e tanishme janë të larta apo të ulëta dhe si ato

mund të stimulojnë përputhshmërinë fiskale. Literatura mbi tatimet thotë si efekti pozitiv i dënimeve në përputhshmërinë tatimore (p.sh. sa më të larta dënimet, më shumë rrezik nga mospërputhja), sjell një nivel më të lartë të përputhshmërisë. Kuptohet, një nivel i lartë i dënimeve mund të ketë efekt negative, nëse bizneset konsiderojnë që ndëshkimi mund të mos jetë i mundur; kjo e bën edhe korrupsionin më shumë të mundur, siç ndodhë shpesh me rregullime të tepërta.


Sa i përket administratës tatimore, bizneset thonë që ato shpesh marrin rryshfet dhe inspektorët tatimor keqpërdorin autoritetin. Në shkallë prej 1 deri 10 (1-asnjëherë, 10-shumë shpesh) bizneset kanë mesatare 4.48. Ato,

poashtu, besojnë se zyrtarët tatimor shpesh abuzojnë autoritetin (Mesatarja: 4.35, 1- Asnjëherë, 10- Gjithmonë). Është alarmuese që një numër i madh i bizneseve raportojnë abuzime nga autoritetet tatimore. Autoritetet tatimore në Kosovë vlerësohen nga Qeveria (dhe institucione tjera) si të suksesshme në mbledhje të taksave. Megjithatë, rezultatet e anketës tregojnë se bizneset gjejnë mjaft hapësirë për manovrim. Kur pyeten për gjasat që të zihen duke iu shmangur tatimit (1- pak gjasë, 10- shumë gjasë), të anketuarit dhanë një mesatare prej vetëm 5.51. Rrjedhimisht, ka 50 përqind gjasë që mos të zihen. Bi-

37.3 përqind të të anketuarve thanë që kanë gjasa të mëdha apo tepër të mëdha që një biznes të zihet duke ju shmangur tatimit. **62.7 përqind** besojnë që lehtë mund të ju shmangen tatimit.

Figura 2. Shitjet e pa raportuara për shkak të taksave (kryqëzimi me nivelin e shitjeve)


■ Evazoni i taksave dhe niveli i shitjeve



Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Figura 3. Përqindja e shitjeve të pa raportuara sipas rajonit

■ Përqindja e shitjeve të pa raportuara



Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

zneset e konsiderojnë nivelin e tatimeve të jetë relativisht i lartë (Mesatarja: 6.26, 1- shumë ulët, 10- shumë lartë).

4.1.1 MORALI FISKAL DHE JUSTIFIKIMI I EVAZIONIT FISKAL

Në vitin 1972, Allingham dhe Sandmo adaptuan modelin e Becker (1968) të ekonomisë së krimit për të shpjeguar se si një individ, në kushte të pasigurisë, merr vendimin të bindet. Modeli i thjeshtë tregon që niveli i evazionit fiskal varet nga niveli i taksave, auditimit dhe dënimeve (kryesisht faktorët parandalues). Modeli tradicional është kritikuar për thjeshtëzim të tepërt. Zhvillimet e mëpasshme në literaturën e evazionit fiskal

kanë argumentuar në favor të inkorporimit të përcaktuesve tjerë jo-traditional, në mënyrë që të përfshihen si faktorët tjerë, ërpos atyre parandalues.


Gati tre dekada nga paraqitja e modelit të Allingham dhe Sandmo (1972), Sandmo (2004) argumenton që, shpjegimi bazuar në gjasat subjektive të taksapaguesit, që jo domosdoshmërisht barazohet me frekuencën e auditimit, nuk shpjegon bindshëm problemin në mes të kërkimit empirik dhe pritjeve teorike. Ai argumenton (p.11):

Mendimi praktik dhe vërtetimet e përditshme na tregojnë që njerëzit nuk bëjnë evazion fiskal – si përshembull: nuk tejkalojnë shpejtësinë e lejuar, nuk vjedhin nga dyqani, apo nuk ndotin ambientin – jo vetëm për shkak të gjasave për tu dënuar, por për shkak të arsyeve që kanë të bëjnë me konsideratat sociale dhe morale të tyre.

Frey dhe Feld (2002) argumentojnë që evazoni fiskal përcaktohet nga një kontratë tatimore psikologjike në mes të autoriteteve tatimore dhe qytetarëve dhe se, që kjo kontratë të mbështetet, nxitje në formë të shpërblimeve apo ndëshkimeve duhet të aplikohen; si dhe duhet të konsiderohen besnikëritë dhe lidhjet emocionale që shkojnë përtej shkëmbimeve. Për të shpjeguar problemin e evazionit fiskal, Frey (1997) argumenton për rëndësinë e “motivimit të brendshëm” të përputhshmërisë tatimore që, mbi “virtutin civil”, i bën taksapaguesit të binden; kundrejt “motivimit të jashtëm”, që njihet si parandalues, pasi taksapaguesit paguajnë për shkak të frikës së ndëshkimit. Ky “motivim i brendshëm” njihet sot si morali fiskal.

Për të matur moralin fiskal në këtë studim, aplikojmë teknikën standard, duke pyetur anketuesit të justifikojnë apo jo – në shkallë prej 1 në 10 – nivelin e evazionit tatimor në Kosovë.

Figura 4. Justifikimi i mundshëm (në përqindje)



Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Siç pritet (shih Figurën 4), shumica e të anketuarve – rreth 56 përqind – janë përgjigjur që nuk justifikojnë evazionin fiskal, nëse është i mundur.

Prej Figurës më lartë, është e rëndësishme të shihet se rreth 9 përqind e bizneseve gjithmonë do ta justifikonin evazionin fiskal. Të dhënat e marra na mundësojnë që të krahasojmë moralin fiskal të bizneseve në Kosovë me moralin fiskal në botë, duke përdorur të dhëna nga World Value Surveys (WVS). Natyrisht supozimi këtu është që morali fiskal individual mund të shërbejë si indikator për moralin fiskal biznesor. Të dhënat nga WVS-ja mbulojnë anketat në 55 shtete në tërë botën për periudhën 2005 dhe 2007 (kujdes, jo të gjitha anketat janë bërë në kohën e njëjtë). Kur i krahasojmë ekstremet negative, që do të thotë të anketuarit që gjithmonë justifikojnë evazionin tatimor, Kosova me 9 përqind renditet afër me Serbinë (15 përqind), si vend fqinj. Kjo afërsi mund të jetë indikator i besueshmërisë tek të dhënat tona. Kosova është ndër Indinë (8.9 përqind) apo Brazilin (8.6 përqind), dhe konsiderueshëm ndër shtetet përëndimore.

Rezultate të ngjashme janë nxjerrë në pyetjen e justifikimit të evazionit fiskal atëherë kur konkurrentët ju shmangen taksave, jo vetëm kur shmangia është e mundur. Ne nuk gjejmë dallim të madh varësisht se si frazohet pyetja, nëse pyesim se sa e justifikojnë evazionin “kur është e mundur” apo kur janë të shtyrë nga “konkurrenca jo-fer”, pra kur konkurrenca e bën këtë gjë. Megjithatë, fakti që mbi 40 përqind e të anketuarve do të justifikonin evazionin fiskal – pa marrë parasysh shkallën – është mjaft alarmues. Mund të ketë disa arsye mbrapa nivelit të ulët

të moralit fiskal në Kosovë. Disa nga arsyet mund të gjenden në rezultatet e anketës. Për shembull, duke marr parasysh nivelin e shërbimeve ndaj firmave, 60 përqind e pronarëve besojnë se duhet të paguajnë më pak taksa; 35 përqind besojnë që duhet të paguajnë shumën e njëjtë që paguajnë tani; derisa vetëm 5 përqind besojnë që duhet të paguajnë më shumë. Grafiku në vazhdim (5) paraqet përgjigjet në pyetjet e justifikimit moral të evazionit në disa raste të ndryshme:


Siç shihet qartë në grafikun lartë (Fig. 5), të anketuarit nuk e justifikojnë shmangien nga tatimi në asnjë rast, por ka një rezultat pak më të lartë për pyetjet lidhur me nevojën ekonomike të evazionit dhe padrejtësinë e sistemit tatimor. Argumenti i nevojës ekonomike justifikohet me presionin nga konkurrenca që shkaktohet nga shmangësit e tatimit. Padrejtësia e sistemi ka të bëjë me të parën, por edhe me sistemin e nivelit të taksave; norma e sheshtë e taksave në biznese shihet si jo e drejtë nga disa biznese, sepse mendojnë që bizneset e mëdha duhet të paguajnë më shumë.

Lidhje tjera të rëndësishme që kemi gjetur ekzistojnë në mes të evazionit fiskal dhe faktorëve si mosha e menaxherëve, gjinia, apo nëse biznesi është pjesë e ndonjë organizate apo ode ekonomike. Ne gjejmë një lidhje statistike të rëndësishme, dhe me 99 përqind nivel të besueshmërisë, që menaxherët ndër 35 vjeç bëjnë më pak evazion fiskal. Ironikisht, këta menaxherë justifikojnë më shumë evazionin sesa kolegët e tyre më të vjetër që bëjnë më shumë evazion. Mekanizmi shkaktarë nuk është i njohur, por gjetja është e rëndësishme. Ne nuk gjejmë dallim në mes të menaxherëve meshkuj apo femra (0.9 pikë përqindje më shumë shitje deklarohen nga meshkujt, statistike të parëndësishme). Ngjashëm, nuk ka dallim në mes të bizneseve që janë pjesë e odave të biznesit dhe të tjerave (1 pikë përqindje më shumë shitje raportohen nga jo-anëtarët).

4.1.2. NJË KËRKIM EMPIRIK

Përveç statistikave të përgjithshme deskriptive të dhëna në këtë studim, është bërë edhe një kërkim empirik i përcaktuesve kryesor të evazionit fiskal, bazuar në teoritë e fundit në literaturën e evazionit fiskal dhe moralit fiskal, veçanërisht nga Torgler et al. (2010) dhe Alm dhe McClellan (2012). Pyetësi ka qenë i dizajnuar për të përfshirë një kombinim të përcaktuesve tradicional të evazionit fiskal (taksave, auditimit dhe nivelit të dënimeve) të dhënë nga modeli Allingham dhe Sandmo (1972); si dhe një grupi të përcaktuesve jo-traditional që janë përfshirë përgjatë katër dekadave të hulumtimit në fushën e evazionit fiskal. Andreoni et al. (1998, p. 850) kanë argumentuar në favor të inkorporimit të dinamikave sociale dhe morale, përtej

Figura 5. Arsyetimi i evazionit fiskal, 1-Pajtohem ployësisht, 6-Nuk pajtohem aspak



Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

përcaktuesve tradicional: “...është sugjeruar që faktorët si obligimi moral për të qenë i sinqertë, apo pasojat sociale të të qenit mashtruesit e njohur, mund të jenë stimulues të palogaritur në modelin tone”. Për më shumë, përveç taksave, auditimit, dhe nivelit të dënimeve, ata shtjellojnë tre grupe të faktorëve që janë të rëndësishëm në modelin e evazionit fiskal. Grupi i parë ka rregulla dhe ndjenja morale; grupi i dytë lidhet me drejtësinë e sistemit tatimor; dhe grupi i fundit përfshinë vlerësimet e taksapaguesve për qeverinë si dhe standardet e performances, korrupsionit dhe transparencës. Duke marr parasysh kontekstin biznesor të evazionit fiskal në këtë studim, ne paraqesim edhe një grup karakteristikash të firmave që dalin të jenë përcaktues shtesë.

Në vijë me gjetjet e fundit teorike dhe empirike në fushën e evazionit fiskal, për të kërkuar përcaktuesit e evazionit fiskal të bizneseve në Kosovë, ne do ta përdorim modelin:

$$TAXEVASION_i = \beta_0 + \beta_1 TRADITIONAL_i + \beta_2 INSTITUTIONAL_i + \beta_3 INDCTRL_i + \epsilon_i$$

Ku indeksi i referohet vrojtimit 1,...,n. $TAXEVASION_i$ është niveli i evazionit fiskal për vrojtimitin i ; $TRADITIONAL_i$ përfshinë tre faktorët tradicional të modeluar në Allingham dhe Sandmo (1972), pra nivelin e Tatimeve, nivelin e Auditimit, dhe nivelin e Dënimeve. Grupi i dytë i variablave $INSTITUTIONAL_i$ përfshinë Moralin Fiskal,

Besimin në Qeveri, si dhe Kostot e Përputhshmërisë. Grupi i tretë përfshinë karakteristikat e firmës (si Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Madhësinë e Firmës) dhe karakteristikat e pronarit (si gjininë, moshën dhe nivelin e shkollimit).

Ne përdorim modelin Tobit për të llogaritur përcaktuesit e evazionit fiskal. Sipas Wooldridge (2003), optimizimi shpesh sjell zgjedhje “të papërziera” (ku marrim shumë prej njëres, dhe asgjë prej tjetrës) për një pjesë të konsiderueshme të popullatës; me fjalë tjera, është optimale të zgjedhim zero evazion. Rreth 20 përqind e të anketuarëve kanë deklaruar përputhshmëri të plotë p.sh. zero evazion, prandaj evazoni fiskal ka një shpërndarje të gjerë të vlerave pozitive, por me një grumbull të madh te vlera zero. Pa marrë parasysh këtë, modeli linear ka të ngjarë të tregojë vlera negative për disa nga firmat, përderisa përdorimi i modelit i logaritmit natyral nuk është i mundur pasi shumë vrojtme janë në zero. Prandaj modeli Tobit është i dizajnuar për të modeluar variabla të pavarura që sjellin rezultate “të papërziera”.

Tabela 1 është një përmbledhje e matjeve Tobit. Detajet teknike të modelit ekonometrik të përdorura këtu janë në dispozicion nga autori, sipas kërkesës. Vëreni që në regresionin Tobit, dikush nuk mundet thjeshtë të interpretojë koeficientin β si efekti i X_i në Y_i , siç do ta bënte në kontekstin e modelit linear.

Tabela 1. Rezultatet Tobit

	1	2	3
Përcaktuesit Tradicional			
Niveli i Taksave	2.84 ***	1.80 ***	2.40 ***
Niveli i Auditimit	-2.55 **	-1.62 **	-2.16 **
Niveli i Dënimeve	0.48	0.30	0.04
Përcaktuesit Institucional			
Morali Fiskal	-15.33 ***	-9.99 ***	-13.10 ***
Besimi në Qeveri	-2.25 **	-1.43 **	-1.90 **
Kostot e Përputhshmërisë	1.69 ***	1.07 ***	1.43 ***
Karakteristikat e Firmës			
Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit	-7.39 **	-4.68 **	-6.20 **
Madhësia	-0.13	-0.08	-0.11
Karakteristikat e Pronarit			
Mashkull	0.86	0.54	0.72
Mosha	0.12	0.07	0.10
Edukimi Primar	8.39 *	5.59 *	7.29 *
Edukimi Sekondar	5.79 *	3.66 *	4.88 *
Konstantja	31.47 ***		
Sigma	29.13		

*** në 1% nivel të rëndësisë; ** në 5% nivel të rëndësisë; * në 10% nivel të rëndësisë;

Prandaj, duhet të kalkulojmë efektin marginal të kushtëzuar (Kolumna 2) dhe të pakushtëzuar (Kolumna 3), që matin efektin e ndryshimit në çdo variabël të pavarur në evazion që ndodh përmes ndryshimeve në ndodhje të evazionit dhe në prirjen për evazion.

Nuk ka ndonjë rekomandim të qartë për efektin marginal të preferuar, por pasi vlerat e koeficientëve janë të ngjashme, dhe pasi efekti marginal i pakushtëzuar aplikohet për tërë mostrën, ne do të interpretojmë vetëm Kolumnën 3 apo efektet marginale të pakushtëzuara.

Rezultatet nga Tabela 1 tregojnë që vendimi për tu bindur apo jo nga pronarët e bizneseve në Kosovë në shkallë të madhe varet nga faktorët tradicional, kryesisht faktorët parandalues, por edhe faktorët institucional si morali fiskal, besimi apo kostoja e përputhshmërisë. Modeli Tobit gjen efekte signifikante në 1% nivelin e rëndësisë. Kur të gjithë faktorët tjerë mbahen konstant, një rritje në barrierën e taksave për një kategori e rrit evazionin fiskal për 2.4 pikë përqindje. Ndërlidhja pozitive në mes të normës tatimore dhe evazionit fiskal është në përputhje me pritjet teorike dhe kërkimet empirike që janë bërë deri sot në ekonomitë në tranzicion (Abdixhiku et al 2013).

Në shikim më i afërt i analizës deskriptive të anketës vërejmë

ndërlidhje të qartë në mes të rritjes në normën e taksës dhe sjelljes jo-bindëse. Për shembull, vetëm 22 përqind e të anketuarve kanë deklaruar që do të vazhdonin të paguanin shumën e njëjtë të taksave pas një rritje të taksave prej 10 pikë përqindje; pjesa tjetër 78 përqind kanë treguar gatishmëri për tu shmangur taksave në raste të tilla. Norma e evazionit potencial rritet në 82.5 përqind, nëse taksat rritet për 20 pikë përqindje.

Rezultatet empirike nga Tabela 1 tregojnë një relacion negativ dhe lidhje statistikisht të rëndësishme (në nivelin 5 përqind të rëndësisë) në mes të normës së auditimit dhe evazionit fiskal; që sugjeron një rënie në evazion nëse inspektimet bëhen më të shpeshta. Ndërlidhje statistikisht e rëndësishme nuk është gjetur edhe në mes të nivelit të dënimeve dhe evazionit fiskal.

Grupi i dytë i përcaktuesve, siç u përmend, përmban përcaktuesit jo-traditional të evazionit fiskal. Gjetja kryesore e matjeve empirike qëndron në ndërlidhjen në mes të moralit fiskal dhe shkallës së evazionit; ne gjejmë një ndërlidhje të forte negative, statistikisht të rëndësishme, në mes të moralit fiskal dhe shkallës së evazionit. Duke mbajtur faktorët tjerë konstant, evazoni fiskal bie për plotë 13.1 pikë përqindje për një firmë që asnjëherë nuk e justifikon evazionin fiskal. Vlera

e koeficientit, mbështetur nga rëndësia statistike, na jep bazë të forte të konsiderojmë moralin fiskal si përcaktuesin kryesor të evazionit fiskal në Kosovë.

Për më tepër, relacioni në mes të taksapaguesit dhe Qeverisë, që matet nga besimi në Qeveri, del të jetë statistikisht i rëndësishëm në nivelin 5 përqind. Evazoni fiskal bie për afër 2 pikë përqindje kur besimi në qeveri është për një kategori më të lartë. Kjo gjetje është në linjë me konsiderimet dhe pritjet teorike. Hanousek dhe Palda (2004), ndër të tjera, analizojnë evazionin fiskal si formë proteste legjitime nga qytetarët kundër Qeverisë.

Rëndësia e marrëdhënieve institucionale në mes të firmave dhe qeverisë konfirmohet nga rëndësia statistikore e kostove të përputhshmërisë për firmat. Firmat që shpenzojnë shumë kohë duke u marr me shkresa dhe tjera kërkesa, ka më shumë të ngjarë t'iu shmangen tatimit.

Grupi i tretë, dhe i fundit, i faktorëve, siç pritjet zbulon që karakteristikat individuale të firmave dhe pronarëve janë rëndësishme për të trajtuar problemin e evazionit. Shohim për shembull një marrëdhënie të rëndësishme në nivelin e rëndësisë 5 përqind për variablën “Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit” që evazoni është për 6.2 pikë përqindje më i vogël për biznesin që ju binden këtyre standardeve.

Së fundmi, shohim një marrëdhënie pozitive në mes të evazionit fiskal dhe shkallës së shkollimit të pronarit. Evazoni fiskal është më i ulët për pronarët më të edukuar. Ne nuk arrijmë të gjejmë ndonjë lidhje statistikisht të rëndësishme në mes të madhësisë së firmës, gjinisë, dhe moshës së pronarit, kundrejt nivelit të raportimit fiskal; megjithatë, kahja e shenjës së koeficientit është në përputhje me pritjet paraprake teorike.

4.2. INFORMALITETI NË FUQINË PUNËTORE NË KOSOVË

Pas analizës empirike dhe përshkruese të evazionit fiskal në Kosovë, fokusi i dytë i këtij studimi do të orientohet drejt informalitetit në fuqinë punëtore. Në të vërtetë, vlerat e ndryshme lidhur me nivelin e papunësisë gjithnjë kanë qenë subjekt i studimeve të ndryshme për nivelin e informalitetit në sektorin privat. Ky studim ka për qëllim të ofrojë një vlerë të përafërt për nivelin e punëtorëve të paregjistruar apo të nën-deklaruar brenda firmave të Kosovës. Ashtu siç është shpjeguar fillimisht, fokusi i këtij studimi nuk i mbulon bizneset e pa regjistruara, apo ato që janë tërësisht jo-formale.

Në mënyrë që të kuptohet niveli i informalitetit të fuqisë punëtore në Kosovë, brenda bizneseve të regjistruara, ne i kemi përpiluar dy pyetje të rëndësishme në pyetësorë. Pyetja e parë, ngjashëm me atë të evazionit fiskal, është matës indirekt i taksave të punëtorëve që nuk deklarohen tek autoritetet e shtetit nga bizneset që operojnë në sektorin e njëjtë si respondentët. Pyetja e dytë është direkte. Edhe pse potencialisht mund t'i nënshtrohet një paragjykimi të “vërtetësisë” nga përzgjedhja e mostrës, ajo pyet pronarët e intervistuar të ofrojnë një numër të fuqisë punëtore të pa-regjistruar në bizneset e tyre.

Pyetja e përpiluar, për të matur nivelin e fuqisë punëtore të paregjistruar për të fshehur taksat, ishte:

P.29 Çfarë përqindje të fuqisë totale punëtore një firmë tipike nga fushëveprimi juaj do të vlerësonit se raportohet tek autoritetet tatuese, duke pasur parasysh vështirësitë t'u binden taksave dhe rregullave tjera?

Respondentët janë kërkuar të ofrojnë një përgjigje lidhur me proporcionin e fuqisë punëtore të deklaruar tek autoritetet, e matur në përqindje. Përgjigjja paraqet një shifër të përputhshmërisë me nivelin e fuqisë punëtore, e cila më pas zbritet nga 100 për të vërejtur nivelin real të fuqisë punëtore të nën-deklaruar. Menaxherët dhe pronarët e intervistuar besojnë se bizneset në industrinë e tyre në mesatare raportojnë 63 përqind të punëtorëve. Kjo do të thotë që në mesatare 37 përqind të fuqisë totale punëtore nuk raportohet. Veçanërisht, numri i njëjtë (37 përqind) zbulohet edhe nga pyetja direkte. Ky fakt i rëndësishëm mbështet fuqishëm zbulimin, duke ofruar efikasitet të metodologjisë e cila aplikohet në këtë hulumtim. Ne kemi pyetur respondentët që të tregojnë numrin e punëtorëve me orar të plotë të cilët nuk janë të regjistruar; p.sh. punëtorë që janë tërësisht jo-formal. Më pas e kemi zbritur këtë numër nga fuqia punëtore e cila është deklaruar në fillim të pyetësorit – që ka qenë pjesë e ekzaminimit – për secilën firmë. Duke marrë mesataret e përmasave individuale të fuqisë punëtore jo-formale krahasuar me tërë fuqinë punëtore, kemi arritur në një përqindje të fuqisë totale punëtore të pa regjistruar në Kosovë, e cila mesatarisht është 37 përqind.

Duke u referuar në raportin HDR të UNDP nga viti 2012, vërejmë që rreth 30 deri në 40 përqind të fuqisë punëtore ka qenë jo-formale. Këto studime korrespondojnë me njëra tjetrën, duke theksuar që një pjesë e madhe e fuqisë punëtore nuk është e deklaruar formalisht.


Rezultatet e pyetësorit tregojnë që niveli i informalitetit ndryshon nga sektori në sektorë. Megjithatë, ashtu edhe si e paraqet analiza e literaturës, deklarimi më i ulët i punëtorëve është



Rezultatet e pyetësorit tregojnë që në mesatare **37 përqind** të fuqisë totale punëtore të punësuar nuk është ligjërisht e deklaruar

Figura 6. Fuqia punëtore e pa regjistruar pë r ti ikur taksave ndër sektorë të ndryshëm (në përqindje)

■ Fuqia punëtore totale e pa regjistruar ndër sektorë të ndryshëm



Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në rezultatet e pyetësorit

në sektorin e bujqësisë, me vetëm 30 përqind deklarim (shih Figurën 6). Rezultatet janë interesante pasi që ato tregojnë që sektori i dytë më evaziv sa i përket deklarimit të punëtorëve është sektori i prodhimit dhe përpunimit. Përderisa bujqësia ndikohet nga ndryshimet sezonale, mund të priten lëvizje të fuqisë punëtore në këtë sektor, megjithatë deklarimi i ulët i fuqisë punëtore në sektorin e prodhimit është befasues. Sektori me deklarimin më të lartë të fuqisë punëtore është edukimi, me 82.5 përqind.

Duke marrë në konsideratë që rreth 60 përqind të popullsisë së Kosovës jeton në zona rurale, dhe mbështeten në bujqësi për gjenerim të të ardhurave (Agrikultura dhe Zhvillimi Rural, KE), është evidente që niveli i informalitetit është shumë i lartë nëse marrim parasysh që vetëm 30 përqind të fuqisë punëtore në këtë industri deklarohen. Këto të dhëna korrespondojnë me ato të HRD-UNDP (2012), ku tregohet që vetëm 2 përqind i të gjitha bizneseve të regjistruara janë në sektorin e bujqësisë, edhe pse niveli i punësimit në këtë sektor është rritur gjatë viteve 2009 dhe 2010. Ky është indikator që në Kosovë shumë pak biznese në bujqësi punojnë formalisht, dhe si e tillë kjo shpjegon nivelin e ulët të deklarimit të punëtorëve.


Fakti që një pjesë e madhe e fuqisë punëtore nuk është deklaruar, krijon një barrë të madhe për këta punëtorë të cilët nuk janë të deklaruar. Punëtorët që nuk janë të regjistruar nuk mund të ngrehin padi ndaj punëdhënësit nëse ata nuk trajtohen

barabartë. Punëtorët e pa regjistruar nuk kontribuojnë në trustin pensional dhe në këtë mënyrë ata bëhen barrë për gjeneratat e ardhme. Për më tepër punëtorët në sektorin jo-formal zakonisht paguhen më pak se kolegët që punojnë formalisht. Në anën tjetër, barra e mirëmbajtjes shoqërore zhvendoset drejt punëtorëve, të cilët janë të regjistruar dhe të cilët duhet të kontribuojnë për ta mbuluar hendekun nga punëtorët e pa regjistruar dhe për ata të cilët nuk punojnë. Në përputhje me këto rrethana, bizneset të cilët nën-deklojnë fuqinë punëtore nuk kontribuojnë të holla shtetit, me të cilat mjete shteti ofron rrjet të sigurisë shoqërore. Në këto raste, bizneset dhe punëtorët vejnë prioritet arritjet afat-shkurta, krahas atyre afat-gjata (Kosovo HDR, 2012).

Një tjetër rezultat i rëndësishëm nga pyetësori është që 409 prej 600 bizneseve (68.2 përqind) të intervistuar, deklarojnë që punëtorët e tyre kërkojnë të paguhen me para të gatshme. Ndërsa kompanitë në mesatare paguajnë 66.6 përqind të pagave dhe benefiteve të punëtorëve përmes transfereve bankare. Kur pagat kryhen përmes bankës, është e detyrueshme të deklarohen taksat e punëtorëve andaj edhe të deklarohen punëtorët. Megjithatë, kur ata paguhen me para të gatshme, atëherë nuk ka nevojë për punëdhënësin të deklarojë punëtorin. Për më tepër, punëtorët nuk do të kenë motivim të deklarojnë taksat e tyre nëse ata paguhen me para të gatshme, sepse ata donë të mbajnë sa më shumë që është e mundshme nga ajo shumë.

68.2 përqind
të bizneseve të
intervistuar,
deklarojnë që
punëtorët e tyre
preferojnë të paguhen
me para të gatshme
sesa përmes bankës

Figura 7. Ndikimi i ligjit të punës dhe pagës minimale



Kalkulimet e autorit bazuar në rezultatet e pyetësorit

4.2.1. LIGJI I PUNËS

Ligji i ri i punës – i cili hyri në fuqi në vitin 2010 – ka ofruar disa të drejta bazike për fuqinë punëtore në Kosovë. Megjithatë ligji ka shkaktuar kundërshtime lidhur me ndikimin që ai ka në praktikën e punësimit. Përshtypja e përgjithshme është që ligji, posaçërisht provizioni i pushimit të lehonisë, ka shkaktuar pengesa të shumta, përfshirë edhe në punësimin e grave.


Ne kemi orientuar hulumtimin edhe drejt përshtypjeve të bizneseve lidhur me ligjin e punës dhe pagën minimale. Kemi filluar duke pyetur respondentët nëse ata kanë dëgjuar për ligjin e ri të punës. Befasisht, rreth 41.2 përqind të bizneseve të intervistuar deklarojnë “Jo” dhe rreth 57.2 përqind deklarojnë “Po”. Niveli i lartë i mungesës së njohurisë për ligjin e ri të punës është shumë fatëkeq; për më tepër është shumë e mundshme që këto biznese nuk i binden këtij ligji.

Niveli i lartë i përgjigjeve pozitive është marrë nga respondentët, kur ata janë pyetur nëse janë në dijeni me kërkesat e pagës minimale. Rreth 73.3 përqind të tyre janë përgjigjur me “Po”, ndërsa pjesa e mbetur 26.7 përqind janë përgjigjur me “Jo”.

Ne gjithashtu analizuar ndikimin që ka ligji i ri i punës dhe paga minimale në këto biznese, të cilat janë në dijeni për ekzistimin e tyre. Fillimisht, kur ligji u aprovua, përshtypjet e para ishin që ligji do të ndikojë në: (i) orët e punës, (ii) kompozicionin me disbalanc gjinor në punë, (iii) kontrata afat-shkurta për gratë.

Figura 8. Ndryshimet e propozuara nga respondentët për ligjin e punës (në përqindje)

■ Nëse do të mund të ndërronit diçka në ligjin e punës, çfarë do të ishte?



Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Figura 7 paraqet rezultatet respektive. Vëreni që, sipas bizneseve të intervistuar, të dyja “paga minimale” dhe “ligji i punës” kanë ndikuar në kostot operacionale të bizneseve. Për më tepër, bizneset pohojnë se janë shtyrë të punësojnë gratë me kontratë afat-shkurtër apo jo-formalisht. Detajet se si ka ndikuar ligji i punës në punësimin e femrave elaborohen më tutje edhe në rastin e studimit.

Rreth **41.2 përqind** të bizneseve të intervistuar kanë deklaruar që ata asnjëherë nuk kanë dëgjuar për ligjin e ri të punës ose kërkesat e tij.

Duke i konsideruar barrierat që bizneset hasen në momentin që ligji i ri i punës hyri në fuqi, respondentët patën mundësinë të rekomandojnë ndryshime në ligj (shih Figurën 8). Këto rekomandime tregojnë që punëdhënësit konsiderojnë pagesën e pushimit të lehonisë shumë të lartë – deri në atë pikë ku 8 përqind të bizneseve të intervistuar besojnë që pushimi i lehonisë duhet të hiqet tërësisht. Rreth 14 përqind të bizneseve flasin në favor të zvogëlimit të pushimit të lehonisë në 6 muaj ose më pak, ndërsa 24 përqind të tyre sugjerojnë në uljen e ditëve të pushimit me pagesë. Më tepër se 37 përqind rekomandojnë ndryshime në mënyrën e pagesës së pushimit të lehonisë. Rekomandimi i përgjithshëm është të ndryshohet pagesa e pushimit të lehonisë në mënyrë që 6 muajt e parë të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe muajt e mbetur të mbulohen nga punëdhënësi. Respondentët mendojnë që tjetër alternativë

është të ulet pushimi i përgjithshëm i lehonisë në mënyrë që të jetë e kapshme financiarisht për bizneset.

Në përfundim, shohim se nën-deklarimi i punëtorëve në industri të ndryshme është mjaft i lartë. Një shembull konkret është sektori i bujqësisë ku vetëm 30 përqind të fuqisë punëtore deklarohet, përderisa studimet tregojnë që rreth 60 përqind e popullsisë varet nga ky sektorë. Për më tepër, punëtorët që paguhet me para të gatshme zakonisht nuk i deklarojnë të ardhurat e tyre për qëllim të tatimit. Kjo i vë punëtorët të cilët nuk janë të deklaruar në disavantazh, posaçërisht kur vjen koha e pensionit, apo gjatë marrjes së kredive. Pagesat me

para të gatshme, gjithashtu, ndikojnë buxhetin e shtetit, dhe e zhvendosin barrën tek punëtorët e regjistruar në mënyrë që të mbahet një stabilitet shoqërorë.

Lidhur me pushimin e lehonisë, ligji ka sjellë probleme të cilat kanë rritur koston e operimit të bizneseve. Bizneset paguajnë pjesën më të madhe të pushimit të lehonisë, përderisa shteti mbulon një pjesë të vogël të pushimit të lehonisë. Kjo sjell barrë të madhe financiare, pasi që ata duhet të paguajnë punëtoren që është në pushim të lehonisë, dhe gjithashtu zëvendësimin e punëtorit.

5. RASTET E STUDIMIT

Pjesa në vijim do të prezantojë tri raste të studimit, të cilat janë shkruar nga një gazetare e gazetës Zëri. Këto raste të studimit janë ekzekutuar me qëllim të ofrimit të informatave shtesë ndaj pyetësorit të këtij studimi.

Rasti i parë i studimit, vlerëson pikëpamjet e grave në fuqinë punëtore krahas kërkesave ligjore të ligjit të ri të punës. Rasti identifikon dobësitë kryesore të ligjit të punës, lidhur me barazinë gjinore, dhe po ashtu ofron një vlerësim të kundër efekteve që ligji ka sjellë.

Rasti i dytë i studimit, vlerëson mungesën e fuqizimit ligjorë të kontratave në mes të punëtorit dhe punëdhënësit. Në këtë rast, kushtet e punës, pagesa e orëve shtesë, dhe standardet e sigurisë vlerësohen gjithashtu.

Në fund, rasti i tretë i studimit, analizon nivelin e tanishëm të luftës kundër evazionit fiskal në tërë Kosovën, duke u nisur nga pikat kufitare. Rasti gjithashtu analizon efektet e mungesës së arkave fiskale për shumë kompani dhe si ajo ndikon në konkurrencën jo fer, duke lënë shumë kompani jashtë TVSH-së. Në këtë rast stabiliteti shoqërorë rrezikohet nga kompanitë evazive.

5.1. FEMRAT, VIKTIMË E LIGJIT TË PUNËS

I vlerësuar si ligj shumë i mirë dhe i nevojshëm për gratë shtatzëna, përkundrazi ky ligj ka dhënë efekte negative; gratë ballafaqohen me diskriminim dhe me mundësi të vogla për punësim, ngase punëdhënësit pagesën e lehonisë e konsiderojnë “humbje të parasë”.

Prishtinë - Derisa po qëndronte në pushim të lehonisë, M. Musa, foshnja e së cilës sapo kishte mbushur 2 muaj, merr një email nga punëdhënësi i saj, përmes së cilës njoftohet se i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Ndonëse, kontrata e saj ishte valide edhe për një vit, punëdhënësi i saj vendos ta largojë nga puna për të mos e paguar, edhe pse ai obligohet me ligj të punës.

Por, ndryshe nga qindra nëna tjera kosovare që në raste të tilla zgjedhin të heshtin, Musa vendosi të luftojë për të drejtat e saj.

Me ligjin e ri të punës, i cili ka hyrë në fuqi në muajin nëntor të vitit 2010, ferat kanë të drejtën e pushimit të lehonisë deri në një vit, për dallim prej ligjit të vjetër, kur ato paguheshin vetëm tre muaj pushim pas lindjes.

Gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë, ato paguhen nga punëdhënësi dhe marrin 70 për qind të pagës, 3 muajt tjerë paguhen nga niveli qendror dhe marrin 50 për qind të pagës mesatare në Kosovë, ndërsa tre muajt e fundit u takojnë pa pagesë.

Pagesa nga punëdhënësi 70 për qind të pagës për 6 muaj, ka sjellë kundërshtime të mëdha, sidomos nga sektori privat.

Ligji po len femrat pa punë

I vlerësuar nga ligjvënësit si ligj shumë i mirë dhe i nevojshëm për gratë shtatzëna, ligji përkundrazi ka dhënë efekte negative tek femrat. Si pasojë ato ballafaqohen me diskriminim dhe me mundësi të vogla për punësim. Nuk është bërë ndonjë studim, i cili do të tregonte më saktësisht se prej hyrjes në fuqi të ligjit të ri të punës, sa ka rënë numri i të punësuarve gra, megjithatë të dhënat zyrtare flasin se përqindja e grave të papuna vazhdon të jetë rreth 75 për qind.

Zyrtarët që merren me të drejtat e punëtorëve, ankohen se femrat të cilave u shkelen të drejtat në vend punime, nuk po e kanë guximin që të paraqesin rastet. M. Musa, është një prej shumë pak fermave që ka marrë guximin, që rastin e saj ta çojë deri në fund dhe të mos kërkojë që emri të i mbetet anonim, siç ndodh me gati të gjitha rastet tjera, tregon, Shukrije Rexhepi, shefe në shërbimin profesional në Bashkimin e Sindikatës së Pavarur të Kosovës (BSPK). Kur, Musa merr njoftimin për shpërbërje të kontratës, puna e parë që bën ajo paraqitet në BSPK, tregon Rexhepi.

“Musa nuk ka kërkuar të mbetet anonim, siç kërkojnë gjitha gratë tjera. Kështu, e kam udhëzuar të shkojë edhe në inspektorat të punës. Ka kontaktuar edhe me gratë parlamentare dhe si rezultat i mos heqjes dorë nga të drejtat e saj, punëdhënësi është obliguar që t’ia lëshojë pushimin e lehonisë. Sot ajo është akoma në pushim të lehonisë”, tregon Rexhepi.

Për dy vite, vetëm 12 femra u ankuan

Në vitin 2011, Inspektorati i punës, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, (MPMS) ka pranuar vetëm 4

raste të femrave të cilave iu është shkëlur e drejta e pushimit të lehonisë, ndërsa në vitin 2012, janë 8 raste, gjithsej 12 raste për dy vite, tregon kryeinspektori i punës, Basri Ibrahim. Të 12 rastet, me të cilat është marrë Inspektorati i Punës, kanë rezultuar në favor të gruas, tregon ai.

Por, numri i rasteve të paraqitura dhe të identifikuara nga inspektorati është shumë i vogël në krahasim me sa mund të jetë në realitet. “Nuk mund të jenë vetëm 12 raste për dy vite, mirëpo ato nuk paraqiten, nga frika që e humbin vendin e punës. Pastaj është një tjetër problem, sepse ato e shohin se ka krizë ekonomike, se është vështirë të gjejnë një punë tjetër, andaj preferojnë të heshtin të mos e gëzojnë të drejtat e pushimit të lehonisë, vetëm që të mbajnë punën”, u shpreh Ibrahim.

Edhe ato gra që paraqiten në inspektorat, kërkojnë të mbesin anonim, e ka raste kur një grua është paraqitur në Inspektorat të Punës dhe inspektorët më pas kanë kërkuar llogari tek punëdhënësi i saj, por e njëjta grua është tërhequr nga deklaratat e saj dhe ka mohuar se i janë shkëlur të drejtat, tregon Ibrahim, i cili shton se nëse nënat preferojnë heshtjen, të drejtat e tyre do vazhdojnë të shkelen.

Shukrije Rexhepi nga BSPK, tregon të njëjtin problem, kur gratë shpesh vizitojnë zyrat e saj, tregojnë për diskriminimet e ndryshme që u bëhen nga punëdhënësit, megjithëkëtë nuk tregojnë emrat, ose i tregojnë me kusht që të mbesin anonim, e ka edhe prej tyre që shkojnë një herë e të nesërmen nuk paraqiten më, e si pasojë e kësaj mungojnë edhe evidencat se sa femra paraqiten në javë, muaj apo vit për shkëlje të të drejtave të tyre në vendpunime.

“Prej se ka hy në fuqi ky ligj, unë e mbaj mend vetëm M. Musa si një grua që nuk ka hezituar, që nuk ka fshehur emrin. Pra vetëm një, kjo është shqetësuese”, shprehet Rexhepi.

Rreziku për shkurtimin e pushimit të lehonisë

Megjithëse mungojnë analizat, dyshimet që një grua, tani ka më pak mundësi punësimi, sidomos ato që kanë moshën e lindjes, janë të mëdha, tregon kryeinspektori i punës, Ibrahim. Si rrjedhojë, kanë nisur edhe debate të shumta dhe kërkesa të shkurtimit të pushimit të lehonisë, jo vetëm nga sektori privat, por edhe zyrtarë qoftë nga shoqëria civile apo edhe deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Suzana Novobërdali, deputete nga Alenca për Kosovë të Re (AKR), e cila udhëheq Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, thotë se shkurtimi eventual i pushimit të lehonisë duhet lidhur me natyrën e punës konkrete të të

punësuarës, që lidhet me fillimin e shfrytëzimit të lehonisë (me dispozitën e ligjit aktual-28 ditë para se kur pritët të lind), pushimi intensiv i lehonisë p.sh. pesë muaj, puna me orar të shkurtuar deri katër muajt tjerë.

“Por, prapë kjo çështje kërkon debat gjithëpërfshirës duke shfrytëzuar praktikën më të mira, konsulencën me grupin e ekspertëve nga lëmit e ndryshme”, tha Novobërdali.

Vitin e kaluar Oda Amerikane Ekonomike në Kosovë, pati propozuar që nga 12 muaj pushimi i lehonisë të shkurohet në 9 muaj. Ky konkludim, sipas tyre ka ardhur për shkak se pushimi i zgjatur i lehonisë është barrë e madhe për bizneset, e si pasojë ato kanë filluar të evitojnë punësimin e femrave në proceset e tyre të rekrutimit.

Sipas Odës Ekonomike Kosovare, nuk duhet të ndodhë shkurtimi i pushimit të lehonisë, por duhet gjetur një mënyrë tjetër e pagesës. Një propozim i tyre është që 4 muaj e gjysmë e parë të pushimit të lehonisë, nënat të paguhet nga punëdhënësi 70 për qind të pagës, ndërsa 4 muaj e gjysmë të tjerë nga MPMS-ja, njëjtë me 70 për qind të pagës së lehonisë dhe dy muaj e fundit pa pagesë.

I gjithë ky problem i lehonave nuk do të ekzistonte sikur të ishte ligji për sigurime shëndetësore, thotë Shukrie Rexhepi nga BSPK-ja. “Me fondin mbi sigurime shëndetësore, automatikisht ishte zgjedhur kjo çështje. Sepse fondi do mbulonte pagesën e lehonisë”, tha Rexhepi.

Me këtë pajtohet edhe kryeinspektori, Basri Ibrahim. Ai thotë se në mungesë të ligjit për sigurime shëndetësore, janë këto probleme. Sidoqoftë, ai njofton se këtë vit do të del në shqyrtim plotësimi dhe ndryshimi i ligjit të punës, ku ndër nenet që do diskutohen do të jetë edhe ai për pushimin e lehonisë.

Alma Lama, deputete në Kuvendin e Kosovës, thotë jo vetëm që pushimi i lehonisë nuk duhet shkurtuar, por madje shteti duhet të ndjekë politika të inkurajimit të lindjes së më shumë fëmijëve, pasi statistikën tregojnë se lindshmëria në Kosovë po bie me shpejtësi.

Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës, në vitin 2011 janë shënuar 34.449 lindje në Kosovë, ndërsa në vitin 2012, numri i lindjeve ka rënë në 27.912. Lama ankohet edhe në Inspektoratin e Punës, sipas së cilës ai nuk bën punë të mirë, në mbrojtjen e të drejtave të gruas në vend punime. “Shkeljet duhet gjobitur, duhet shqiptuar gjoja të larta. Por, inspektorët nuk e bëjnë mirë këtë punë, edhe nëse e bëjnë, bëjnë selektive, shumicën e bizneseve nuk i prekin fare edhe nëse gjejnë shkelje”, tha Lama.

Basri Ibrahim i mohon një gjë të tillë. I pyetur nëse ai ka gjobitur ndonjë punëdhënës për këto 12 rastet, Ibrahim tha jo. Por, ai jep sqarim për këtë. Sipas tij, inspektorati nuk e ka qëllimin që me rastin e parë t'i dënojë punëdhënësit. “Njëherë shkojmë me vërejtje, dhe u japim një kohë të shkurtër që të veprojnë, pastaj shqiptojmë gjobat. E në këto 12 raste kemi arritur që vetëm me vërejtje t'i rregullojnë çështjet në favor të punëtorëve”, tha ai.

Përndryshe, sipas tij, diskriminimet në bazë gjinore nuk kanë shumë dallime prej njëra tjetrës. Përveç pushimit të lehonisë që është bërë problem, shkeljet tjera u ndodhin të dy gjinive njëjtë, si puna pa kontrata, paga të ulëta, etj. Në përgjigjësi këto janë evidente tek sektori privat, ndërsa në atë publik, problemet janë tjera, tregon Ibrahim.

“Në sektorin publik, nuk ka probleme të tilla. Ankesat aty më të shpeshta janë vetëm kur shpallet konkursi dhe më pas na vijnë persona që kanë aplikuar dhe se mendojnë se padrejtësisht nuk janë pranuar”, tha ai.

Vetëm 23.4 për qind e femrave të punësuar

Edhe pse Inspektorati i Punës thotë se nuk ka dallime meshkuj-femër, kur vjen puna te shkeljet në punë, fakti që numri i të punësuarve ferma është shumë më i vogël se i meshkujve, e tregon të kundërtën.

Të dhënat në Agjencionin e Statistikave të Kosovës, tregojnë se numri i femrave të punësuar në krahasim me meshkujt është shumë më i vogël. Sipas të dhënave, femra të punësuar gjithsej në Kosovë janë 66 mijë e 719 persona, ose 23.4 për qind, ndërsa numri i meshkujve të punësuar është 214 mijë e 735, ose 76.6 për qind.

Femra vazhdon të mbetet më e diskriminuara në shoqëri, ankohen zyrtarë që merret me të drejtat e njeriut. Behxhet Shala, udhëheqës i Këshillit për të Drejta e Njeriut në Kosovë, thotë se diskriminimi ndaj femrave fillon qysh në shpallje të konkursit. “E keni parë edhe vet, kur aty ceket, që femra që mund të aplikojë nuk duhet t'i ketë më shumë se 30 vjeç. E kjo ndodh në shumë konkurse private. Femra në Kosovë vazhdon të bëjë punë të pa dinjitetshme e shkelur në shumë aspekte, e për të rregulluar këtë, Qeveria nuk ka bërë asgjë”, thotë ai.

5.2 MIJËRA PUNËTORË PA KONTRATA

Prishtinë — Me mijëra punëtorë në Kosovë nuk kanë kontrata të punës. Shumë prej tyre paguhen nën pagën minimale, mbahen edhe jashtë orarit pa pagesë, shumë punëdhënës nuk i lajmërojnë punëtorët e tyre për të mos paguar kontributet shtetit, por ka edhe prej tyre që humbin jetën në vendin e punës, sidomos në sektorin e ndërtimitarisë për shkak të kushteve të rënda dhe askush nuk jep përgjegjësi. Këto të dhëna janë konfirmuar nga mijëra raste të cilat janë identifikuar, mirëpo informaliteti në sektorin e punës mbetet ende problem i madh.

Shkeljet më të mëdha, ndodhin tek sektori privat dhe problem më i identifikuar është puna pa kontratë, ku punëdhënësi fsheh numrin real të punëtorëve, vetëm që t'i ikë tatimit mbi pagë, por edhe obligimeve tjera që është i obliguar para ligjit.

Inspektorati i punës në Kosovë, në kuadër të Ministrisë Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), gjatë inspektimit në sektorët privat, vetëm gjatë vitit 2012 ka identifikuar 3 mijë e 467 punëtorë pa kontrata pune, bën të ditur kryeinspektori Basri Ibrahim.

Kanë qenë 7 mijë inspektime, gjatë së cilës është nxjerr kjo shifër, tregon ai. Ndër të tjera inspektorati ka lëshuar edhe vërejtje tjera, kryesisht për orare të zgjatura. “Shkeljet më të mëdha në sektorin privat janë oraret e stërzgjatura ndaj punëtorëve pa kompensim dhe puna pa kontratë, si pasojë e së cilës vijnë shkeljet tjera”, thotë Ibrahim.

E, ajo që inspektorati ka bërë, në këtë drejtim sipas tij, është se ka arritur që të gjithë këta 3 mijë e 467 punëtorë t'i legalizojnë.

Fillimisht kanë përdorur vërejtjet ndaj punëdhënësve, duke u dhënë një mundësi që t'i shpëtojnë gjobitjes, por jo të gjithë kanë dëgjuar. Andaj, për vitin e kaluar, për shkelje të ndryshme ndaj punëtorëve ky inspektorat ka gjobitur bizneset e ndryshme në një vlerë totale me rreth 585 mijë euro, ku shuma më e vogël e dënimit ka qenë 500 euro, tregon Ibrahim.

Rreth 30 mijë të punësuar ilegal

Rreth 30 mijë punëtorë të Kosovës, konsiderohet se punojnë pa kontrata pune. Kjo shifër është nxjerrë në bazë numrit të qytetarëve të paraqitur si të punësuar, dhe numrit të tyre që paguajnë tatim mbi pagë. Sipas agjencionit të statistikave të Kosovës, numri i qytetarëve të deklaruar të punësuar është 280, 454.

Gjithë këta persona, në bazë ligjit duhet të paguajnë pension dhe tatim në të ardhura. Por, të dhënat e siguruar nga gazeta në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), tregojnë se kontribues të tatimit në pagë janë 250.890 persona, që i bie afërsisht 30 mijë më pak se numri i përgjithshëm i deklaruar i të punësuarve.

E nëse krahasojmë këtë shifër me punëtorët e gjetur pa kontrata nga ana e inspektoratit, me rreth 3 mijë, i bie që kjo shifër është vetëm 10 për qind e numrit të përgjithshëm të atyre që punojnë ilegalisht në Kosovë.

Edhe pse të drejtat e tyre shkelen në mënyra të ndryshme, punëtorët nuk paraqiten për ndihmë. Për gjithë vitin, 2012, në inspektorat të punës, kanë arritur vetëm 400 ankesa të punëtorëve, tregon kryeinspektori, Basri Ibrahim.

Njohësit e problemeve të punëtorëve, vlerësojnë se arsyt që ka numër të vogël ankesash, kanë të bëjnë fillimisht me mos besimin ndaj institucioneve për të gjetur ndihmë, e më pas edhe për shkak të krizës ekonomike, ku para vetes nuk shohin alternativa tjera nëse e humbin vendin ku janë, e rrjedhojë e zgjedhin heshtjen.

Avni Ajdini, nënkryetar i Bashkimit të sindikatave të punëtorëve në Kosovë (BSPK), tregon se punëtorët e kompanisë Bechtel Enka, e kontraktuar nga Qeveria e Kosovës, e cila bën ndërtimin e autostradës Kosovë-Shqipëri, paguhet 0.90 euro orën të cilët mbahen në punë me orare të stërzgjatura dhe nuk gëzojnë kurrfarë të drejta.

“Kam informata që punëtorët duan të themelojnë sindikatën, por punëdhënësi, gjithmonë i stopon. Kjo për shkak se me sindikatë do të kuptoheshin më lehtë problemet. Edhe ne si BSPK do kishim direkt qasje në problemet e tyre dhe më lehtë për t’i adresuar pastaj ato. Kështu nuk po mund të depërtojmë aty. Kjo tregon se shkeljet i bën niveli qendror, i cili vet i krijon ligjet e vet i shkel ato”, thotë Ajdini.

Shembull tjetër, Ajdini merr shembull kompaninë Mabetex, e cila po ashtu nuk ka sindikatë.

Gazeta përkundër përpjekjeve për të marrë deklarata nga përfaqësuesit e Mabetex dhe udhëheqësit e Bechtel Enka, nuk ka arritur. “Ndërkohë që nuk janë të vetme këto kompani që shkelin të drejtat e punëtorëve. Në secilën prej tyre gjen shkelje”, thotë Ajdini.

Sipas tij, kur inspektorati shkon dhe inspekton në këtë rast punëtorët në Bechtel Enka, shkeljet që i gjen nuk i tregon, sepse janë Qeveri, e kjo ndodh edhe në kompanitë tjera. Por, një gjë të tillë e mohon, kryeinspektori Ibrahim. Ai thotë se pavarësisht se çka flitet për punëtorët e Bechtel Enka, aty nuk ka shkelje. Të gjithë kanë kontrata dhe siguri në punë, e

sa i përket pagesës, ajo nuk është çështje e tyre. Me rëndësi, sipas Ibrahimit, është se asnjërit punëtorë në fund nuk i del paga më e ulët se e lejuar me ligj që është 170 euro.

Numri i vogël i inspektorëve, vështirëson punën

Kryeinspektori, Basri Ibrahim, thotë se Kosova numëron rreth 100 mijë biznese, ndërkohë që numri total i inspektorëve për gjithë Kosovën është vetëm 46 inspektorë. “Kemi numër të vogël të inspektorëve, për shkak se ne pos që përcjellim ligjin e punës, se sa respektohet, përcjellim edhe atë për duhanin, persona me aftësi të kufizuara, sindikata, e kjo është ngarkesë shumë e madhe”, tha Ibrahim. Edhe pse sipas tij, krahasuar me vitet para se të miratohet ligji i ri i punës, gjendja e punëtorëve është shumë më e mirë. Informaliteti është një dukuri shqetësuese dhe shumë e përhapur në Kosovë, vlerëson, kryetari i Ajencionit Kosovar të Bizneseve, Agim Shahini. “Joformaliteti në Kosovë mbetet ende sfidë për ta luftuar. Ligji i punës në masë të madhe shkelet nga punëdhënësit”, u shpreh ai.

Një tjetër problem është se punëdhënësi nuk respekton as pagën minimale të caktuar me ligj, që është 170 euro. Ka punëtorë që paguhet 100 euro në muaj, e shpesh herë edhe më pak, tregon nënkryetari i BSPK-së, Avni Ajdini. Raste të shumta në Kosovë, dëshmojnë se kur punëtorët kanë kërkuar të drejtat e tyre, kanë mbetur krejt pa punë. Në tetor të vitit kaluar, kompania turke “Uluova”, e nënkontraktuar nga “Bechtel Enka” ka pushuar 50 punëtorë, pasi që ata kërkuan nga punëdhënësi që t’i paguan orët shtesë, dhe të pushojnë të dielave ashtu siç iu shkruan në kontratë. Kjo situatë pat kaluar pa zhurmë dhe në heshtje, por me anë të së cilës është dëshmuar se edhe kur e ke kontratën, nuk i gëzon të drejtat e garantuara me ligj.

5.3 NGEÇJE NË LUFTIMIN E INFORMALITETIT

Shmangia ndaj detyrimeve shtetërore, nis në pikat doganore dhe vazhdon gjithandej brenda territorit të Kosovës, ku tregtarët përdorin çdo formë korruptive vetëm që të mos paguajnë tatim. Tregu i tillë i pabarabartë, e veçon Kosovën si një vend me informalitet të lart, si pasojë buxheti shtetëror dëmtohet me qindra miliona euro në vit.

Prishtinë - Duke filluar nga pikat doganore, përmes së cilave hyhet në Kosovë, fillojnë edhe korrupsionet që tregtarët përdorin vetëm për të iu ikur tatimit ndaj shtetit, ku njëra prej formave është edhe të korruptosh doganierët, dhe të njëjtit

(tregtarët) vazhdojnë me të njëjtin avaz edhe brenda territorit të vendit, duke bërë kështu që informaliteti në vend të mbetet i lartë.

Të dhëna zyrtare të sakta mbi tregun e zi, mungojnë, megjithatë janë të dhënat e bankës botërore, ndonëse pak të vjetërsuara, sipas të cilave informaliteti në Kosovë arrin në 40 përqind të BPV-së, shprehur në vlerë monetare është rreth 2 miliardë euro. Nga kjo shumë, buxheti i shtetit humbë mbi 300 milion euro në vit (duke llogaritur vetëm TVSH-në).

Nga 120 mijë biznese private të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), prej tyre vetëm rreth 17 mijë posedojnë arkë fiskale, që do të thotë janë tatimpagues të rregullt. Bizneset më profitabile, siç janë pompat e benzinës, asnjëherë nuk lëshojnë kupon fiskal.

Ekonomia joligjore në Kosovë është bërë pjesë e shoqërisë dhe komunitetit të biznesit dhe kjo në masë të madhe po dëmton buxhetin dhe prodhimin, vlerësojnë njohës të çështjeve ekonomike. E përmasat e kësaj dukurie, sipas tyre janë shtuar dukshëm duke nisur nga pikat kufitare, në veçanti ato me Serbinë, ku shumë rrugë alternative vazhdojnë të jenë të frekuentuara për tregti të zi, dhe kontrollimi i tyre është i vështirë e pranojnë edhe vet zyrtarët doganorë të Kosovës.

Por, përveç kësaj, çështja tjetër shqetësuese është ryshfeti që marrin doganierët nga tregtarët e ndryshëm për të iu futur mallin pa paguar tatim, e që edhe pse dihet për këtë fenomen, vazhdon të jetë i vështirë për tu luftuar.

Doganierët e korruptuar

Gjatë vitit 2012, sektorët që merren me luftimin dhe parandalimin e korrupsionit brenda doganës së Kosovës, kanë numëruar 46 raste të zyrtarëve për të cilat kanë raportuar, shqiptuar masa disiplinore dhe proceduar raste në polici e gjyqësi, për shkak se janë zënë duke keqpërdorur pozitën publike.

Sidoqoftë, këto raste, nuk janë treguar nga zyrtarët e doganës së Kosovës, të cilët kanë hezitur të kthejnë përgjigje edhe pse janë pritur me javë të tëra.

Ato janë publikuar nga Agjencia kundër korrupsionit, sipas së cilës prej 46 rasteve të zyrtareve doganorë, 17 raste janë raportuar, ndaj 19 janë lëshuar masa disiplinore, 5 raste janë proceduar në gjykata dhe 5 tjera në polici.

Por nuk ka të dhëna se si janë zënë këta zyrtarë, duke marrë apo duke bërë shkelje tjera gjatë punës. Adriatik Stavi-

leci, zëdhënës në doganën e Kosovës, nuk ka kthyer përgjigje për rastet e tilla, por ka folur në përgjegjësi për këtë çështje. Ai thotë se për të zënë një doganier duke marrë para direkt nga ndonjë tregtar, është punë e vështirë, gati e pamundshme. Por ai nuk e mohon se ky fenomen ekziston, prandaj edhe doganat e Kosovës kanë ndryshuar sistemin e kontrollimit të mallrave që futen në Kosovë.

Nga viti 2007, sistemi i kontrollimit të mallit është shpërndarë, pra derisa më herët ke pas mundësi të futesh mallin në Kosovë duke iu nënshtuar vetëm një kontrollimi, tani është ndryshe, detyrohesh të kalosh nga një kontroll në tjetrën. “E kjo mënyrë e shpërndarjes së kontrollit nga një në tjetër e vështirëson dhe gati e pamundëson që një tregtarë të korruptojë një doganier, sepse nuk ke punë me një por me shumë”, tha Stavileci.

Ryshfeti që mund të marrin qoftë doganierët qoftë zyrtarët në sektorë tjerë, është i vështirë për tu zënë direkt, vlerëson edhe Agim Shahini, nga Aleanca për Biznese në Kosovë.

Sidoqoftë, edhe nëse nuk mund të korruptojnë ndonjë doganier, për të hyrë malli i tyre ilegalisht në Kosovë, tregtarët nuk ndalen, ata përdorin format tjera që janë të shpeshta, siq është futja e mallit përmes zonave të pakontrolluara. “Evazioni është më i madhi nëpër pika kufitare, qoftë në veri të vendit por edhe nëpër pika tjera, gjithandej Kosovës, përmes së cilave hyjnë mallra dhe iu shmangen taksave edhe të doganës edhe të TVSH-së”, tha Shahini. Por sa humb shteti nga ikja e tatimit, është vështirë të flitet, thotë ai.

Eksperti ekonomik, Ibrahim Rexhepi, thirret në të dhënat e bankës botërore, sipas të cilave evazioni fiskal në Kosovë arrin në 40 përqind të BPV-së. “Shprehur në vlerë monetare ai është 2 miliardë euro. Nga kjo shumë, buxheti i shtetit humbë mbi 300 milionë euro në vit, duke llogaritur vetëm TVSH-në”, tha Rexhepi.

Por, zëdhënësi i doganave, insiston se asnjëherë të dhënat e kujt do qofshin ato nuk mund të jenë të sakta. “Askush nuk mund ta dijë sa humb Kosova nga ikja e tatimit. Derisa nuk e zënë atë mall, as nuk mund ta dish sa ka pas aty dhe sa kishte përfituar shteti nga tatimi. Prandaj shifrat milionëshe të publikuara herë pas here nga institucione të ndryshme nuk janë reale”, tha Stavileci.

1.3 milion euro gjobë, për kapjen e mallrave të kontrabanduara

Gjatë vitit 2012 Dogana ka arritur të kap 1007 raste nga të cilat janë shqiptuar gjoba kundërvajtëse në shumë prej mbi 1.3 milion euro, ndërsa ka konfiskuar mallra në vlerë prej rreth 1 milion euro.

Janë këto raste që Doganat e Kosovës kanë zënë tregtarët duke u munduar të i fusin ilegalisht në forma të ndryshme, kryesisht duke përdorur rrugë ilegale, bën të ditur zëdhënësi i doganave, Stavileci. Por nëse krahasojmë me vitin 2011, rastet të kapura kanë qenë 1050, konfiskime në vlerë gati të njëjtë me vitit të kaluar prej rreth 1 milion euro, ndërsa gjohet kanë qenë dy herë më të larta, në vlerë prej 2.8 milion euro. Sipas të dhënave të doganave, mallra të konfiskuara viteve të fundit kanë qenë më shumë ari, automjete, derivate të naftës, barna, cigare, por edhe mallra tjera si veshmbathje, produkte ushqimore, po ashtu edhe gjedhe të gjalla. Ndërsa ka pasur raste kur janë zënë duke kontrabanduar edhe marihuanë, tregon Stavileci. Ndryshe, dogana në aspektin e hetimeve ka vazhduar, të bëjë përcjelljen e bizneseve që operojnë me produkte ilegale.

Kështu këtë vit, oficerët doganorë kanë lokalizuar dhe mbyllur një mini-punëtori për falsifikimin e alkoolit, ku pas kërkesës së prokurorisë është bërë edhe arrestimi i personit. “Ndërsa gjatë vitit 2012 kemi hapur hetime për 48 raste të reja. Gjithashtu si rezultat i hetimeve kemi ushtruar 40 kallëzime penale nën dyshimin e bazuar të evazionit fiskal”, tha ai. Ndryshe ai përmend dy lloje të kontrabandës, që tregtarët përdorin për të futur mallin ilegalisht. Është ajo e quajtur kontrabandë klasike, përmes rrugëve jo të autorizuara, nëpër rrugë malore, por se kjo dukuri në krahasim me vitet e mëparshme, sot frekuentohet më pak, thotë Stavileci. Megjithatë, Kosova ka një vijë kufitare mjaft të gjerë me Serbinë dhe tereni përmes asaj vije është kodrinor dhe lehtë i kalueshëm, prej nga edhe zhvillohet më së shumti kontrabanda, tregon zëdhënësi i doganës. Pastaj është kontrabanda përmes nën-vlerësimit apo kalimi i mallrave me anë të dokumenteve të falsifikuara apo fatura të dyfishta formë kjo më e sofistikuar e tentimit të mos pagesës së saktë të tagrave doganore, thotë ai.

“Për të luftuar këtë dukuri, dogana e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje me doganat e vendeve nga të cilat kemi import, për shkëmbim të të dhënave. Këto marrëveshje e lejojnë doganën e Kosovës të ketë qasje në dokumentet e eksportit nga vendet e origjinës së mallrave dhe si i tillë rastet e nënvlerësimit zbulohen më lehtë”, shtoj Stavileci. Të gjitha këto aktivitete të doganës, sipas Stavilecit kanë bërë që të rriten të hyrat nga doganat. Vitin 2004 të hyrat e grumbulluara nga doganat kanë qenë rreth 400 milionë euro, ndërsa sot janë 850 milionë euro, thotë ai.

Nga 120 mijë biznese, 17 mijë posedojnë arkë fiskale

Shmangia nga detyrimet ndaj shtetit nga ana e tregtarëve, nuk mbaron me pikat doganore, ato vazhdojnë edhe brenda

territorit të Kosovës. Në ministrinë e tregtisë dhe industrisë, të dhënat tregojnë se gjithsej numri i bizneseve të regjistruara në Kosovë, është 120 mijë, këtu përfshihen përveç privatet edhe ato publike, shoqëri aksionare, kompani të huaja, ndërmarrje shoqërore e gjitha të tjerat.

Ndërsa të dhënat e siguruar nga gazeta në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), tregojnë se biznese që paguajnë tatim në arkën e shtetit gjatë vitit 2012 kanë qenë rreth 50 mijë, që i bie më pak se gjysma e numrit total të bizneseve në Kosovë.

Një nismë që Qeveria e Kosovës ka marr përsipër pikërisht për të bërë identifikimin e numrit të saktë të bizneseve dhe për të i detyruar ato që të paguajnë tatim, ka qenë fiskalizimi i nisur vitin 2010, projekt që ka pasur për qëllim që brenda 24 muajve të arrijnë të pajisin me arkë fiskale 50 përqind të bizneseve.

Por, sot sipas Aleanca për Biznese në Kosovë, e udhëhequr nga Agim Shahini numri i atyre që kanë arkë fiskale gjithsej është 17 mijë. “Sot ne kemi rreth 120 mijë biznese të regjistruara, ndërsa vetëm 17 mijë kanë arka fiskale. Kjo tregon se sa i padrejtë është shteti ndaj bizneseve”, thotë Shahini. I padrejtë sipas tij, sepse ka shumë biznese sidomos ato të mëdhatë që janë të lidhura me interesa me institucionet e vendit dhe ato nuk i nguc askush se a paguajnë apo jo tatim. Sipas tij, sot në Kosovë është krijuar një atmosferë që bizneset që nuk kanë lidhshmëri me institucionet, dështojnë dhe mbyllen. Numri i bizneseve në Kosovë që mbyllen brenda vitit, sipas Ministrisë së Tregtisë shkon deri në 1 mijë, por ndërkohë regjistrohen të reja.

Sipas Shahinit, numri i atyre që mbyllen është edhe më i lartë se 1 mijë dhe pavarësisht se hapen tjera, duke u mbyllen të vjetrat, i bie që ekonomia nuk është në zhvillim por në stagnim. “Një prej arsyeve të dështimit të bizneseve të vjetra, është edhe informaliteti, konkurrencës jo të drejtë. Merrni shembull pompat e benzinës, asnjë prej tyre nuk ka arkë fiskale, dhe askush nuk i pengon, kjo është një pabarazi që po shkatërron zhvillimin ekonomik”, tha Shahini.

Si shembull, një biznes që ka arkë fiskale detyrohet që për një cent të paguaj 16 përqind tatim, kurse ai që nuk ka arkë fiskale paguan sipas dëshirës së vet, siq e paraqet vet, kështu shkatërrohet sistemi, tha ai.

Analisti për çështje ekonomike, Ibrahim Rexhepi, thotë se shmangia nga tatimi ndodh gjithkund, por janë mekanizmat shtetërorë ato që e luftojnë atë, e që në rastin e Kosovës, ATK, duket të jetë më agresive sa i përket instalimit të arkave fiskale, që të ardhmen të gjitha bizneset të jenë të barabarta.

6. KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET

Ky studim analizon gjendjen e ekonomisë jo formale në Kosovë. Në përgjithësi, ky studim ka për qëllim të analizojë madhësinë dhe implikimet e aktiviteteve ekonomike jo formale (evazionin e taksave dhe fuqinë punëtore) në zhvillimin ekonomik të vendeve në tranzicion si Kosova. Kjo analizë konkludohet me të dhëna primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë gjithëpërfshirëse, duke inkorporuar 600 biznese të intervistuar nga sektorë të ndryshëm, si dhe tri raste studimi të cilat ofrojnë pikëpamje të gjendjes në teren. Pyetësori është ekzekutuar vetëm me pronarët e bizneseve apo me menaxherët e lartë, për t'u siguruar në kredibilitetin e të dhënave. Në mënyrë që t'i qasemi kësaj teme shumë senzitive me sukses, pyetësori është analizuar dhe testuar në detaje, fillimisht brenda Riinvest-it dhe më pas me 50 biznese, para se të ekzekutohej tërësisht. Pyetësori përmbante shumë pyetje indirekte (duke pyetur për sjelljet e konkurrentëve, e cila gjë në realitet do të ishte indikator i sjelljes së respondentit) dhe pyetje direkte (për sjelljet e vet biznesit).

Aktivitetet jo formale mund të përfshijnë aktivitete *ligjore* (aktivitete të nën-deklaruara por ligjore) dhe aktivitete *jo-ligjore* (p.sh trafikim njerëzorë apo i narkotikëve). Megjithatë, për qëllim të këtij studimi, ne jemi fokusuar në të parën, me qëllim të vlerësimit të dëmit që aktivitetet jo-formale i shkaktajnë ekonomisë së vendit; përfshirë këtu pagat jo të drejta, diskriminim gjinorë, dhe taksa të pa deklaruara të cilat mund ti kenë kontribuar buxhetit të shtetit dhe mirëqenies shoqërore.

Të dhënat e studimit sugjerojnë që informaliteti ose “konkurrenca jo e drejtë” ende qëndron në top listën e barrierave të të bërit biznes në Kosovë. Të dhënat e pyetësorit tregojnë se 34.4 përqind e shitjeve nuk deklarohen, që do të thotë se kontributet ndaj shtetit prej taksave janë për një të tretën më të ulëta se sa që mund të jenë. Gjithashtu, bizneset e vogla dhe të mesme janë në gjendje të involvohen në evazion fiskal më tepër sesa të mëdhat. Për më tepër, sektorët më evaziv në Kosovë janë: bujqësia, prodhimi, dhe shërbimet e hotelarisë dhe ushqimit; përderisa sektorët më pak evaziv janë: ndërtimi, edukimi, rekreacioni dhe arti.

Evazoni fiskal, gjithashtu, ndryshon në 7 rajonet e Kosovës, ku rajoni i Gjilanit është më evaziv (60 përqind), ndërsa rajoni më pak evaziv është ai i Gjakovës (me 20 përqind evazion). Këto informata mund të përdoren për strategji të auditimit të ATK-së. Për më tepër, rreth 62.7 përqind të bizneseve të intervistuar besojnë që ata lehtë mund t'i shmangen evazionit nëse ata vendosin ta bëjnë një gjë të tillë. Këto perceptime ndaj niveleve të auditimit dhe të shkallës

së dënimeve ofrojnë një pamje reale të mekanizmave monitorues në Kosovë. Në fund, bizneset deklarojnë që konkurrentët e tyre japin rryshfet autoriteteve për t'i ikur tatimit (Mesatarja: 4.48) dhe se zyrtarët e taksave abuzojnë me detyrën e tyre (Mesatarja: 4.35).

Lidhur me moralin fiskal, 56 përqind të respondentëve deklarojnë që ata nuk e justifikojnë evazionin fiskal, përderisa 9 përqind deklarojnë që ata shumë shpesh e justifikojnë evazionin fiskal dhe 16 përqind deklarojnë që ata shpesh e justifikojnë evazionin fiskal. Kur këto rezultate janë krahasuar me World Value Survey, Kosova rangohet afër Serbisë (sa i përket justifikimit të evazionit fiskal), ku 15 përqind e bizneseve e justifikojnë shumë shpesh evazionin fiskal, por ne qëndrojmë më afër Indisë (8.9 përqind) dhe Brazilit (8.6 përqind). Ky nivel i justifikimit arsyetohet nga respondentët duke marrë parasysh nivelin e tanishëm të të mirave dhe shërbimeve publike që ata pranojnë. Ata deklarohen se duhet të paguajnë me pak taksa (60 përqind), ndërsa respondentët tjerë (35 përqind) besojnë se duhet të paguajnë nivel të njëjtë të taksave për shërbimet dhe të mirat që i marrin nga shteti.

Në fund, vendimi lidhur me respektimin apo mos-respektimin nga pronarët e biznesit varet shumë nga faktorët tradicional, konkretisht faktorët e pengimit, dhe faktorët institucional si: morali fiskal, besimi ose kostoja e respektimit. Rezultatet tona empirike të modelit të evazionit fiskal tregojnë një relacion pozitiv në mes të shkallës së taksave dhe evazionit fiskal, dhe një relacion negativ në mes të shkallës së auditimit dhe evazionit fiskal. Gjithashtu, zbuluam që morali fiskal luan rol të rëndësishëm në vendosjen e niveleve të evazionit fiskal, përderisa karakteristikat e bizneseve individuale janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm në analizën e evazionit fiskal.

Lidhur me evazionin në fuqinë punëtore, respondentët besojnë se mesatarisht bizneset raportojnë 63 përqind të fuqisë së tyre punëtore. Kjo do të thotë që 37 përqind të fuqisë punëtore në Kosovë mbetet e padekluar ose e pa regjistruar. Evazoni i fuqisë punëtore dallon nga sektori në sektorë. Ky është kryesisht evident në sektorin e bujqësisë, ndërsa sektori më pak evaziv është ai i edukimit. Sektori i bujqësisë ka ndërrimin më të madh të fuqisë punëtore, për shkak të ndryshimeve sezonale, andaj kjo shpjegon nivelin e ulët të deklarimit të punëtorëve.

Pyetësori zbulon që rreth 41.2 përqind e bizneseve të intervistuar nuk janë të vetëdijshëm për ligjin e punës apo kërkesat e tij. Në anën tjetër, 73.3 përqind e bizneseve të intervistuar kanë

njohuri për pagën minimale në Kosovë. Ligji i ri i punës, sipas respondentëve, kryesisht ka ndikuar në koston e operimit për biznese, posaçërisht pushimi i lehonisë. Kjo ka rezultuar në kontrata afat-shkurta për gratë në rastin më të mirë, dhe në rastin më të keq ka ndodhur zhvendosja e tyre në sektorin jo-formal. Shumica e respondentëve rekomanduan ta ndërrojnë metodën e pagesës së pushimit të lehonisë, duke zhvendosur barren më tepër drejt qeverisë (37 përqind), dhe të ulët numri i ditëve të pushimit me pagesë (24 përqind).

Në fund, kemi përpiluar tri raste studimi me përvoja reale të individëve të cilët janë ballafaquar me informalitetin. Rasti i parë i studimit ishte për pushimin e lehonisë dhe diskriminimin që gratë hasin në punë. Rasti i dytë paraqet faktin që shumë punëtorë ende punojnë pa kontrata, gjë që i pozicionon ligjërisht në disavantazh. Ndërsa, rasti i fundit, prezanton nivelin e evazionit fiskal dhe ryshfeteve në kufirin e Kosovës, dhe tregon se si ndikojnë në stabilitetin ekonomik të Kosovës.

Duke marrë parasysh diskutimin dhe zbulimet nga studimi, ne kemi përpiluar rekomandimet politike në vijim:

MBI BARRËN TATIMORE:

- Të ulët barra tatimore, jo domosdoshmërisht duke ulur normën tatimore, por duke ulur kostot e përputhshmërisë fiskale. Norma e ulët tatimore jo domosdoshmërisht ulë barrën tatimore. Siç shihet nga rasti i Kosovës, përkundër normës mesatare të tatimit që është më e ulët në të gjitha ekonomitë e tranzicionit (rreth 10%), niveli i evazionit fiskal është më i larti (39.5%). Arsyeja tjera për barrën tatimore përfshijnë pikat e transaksionit, të cilat mbahen të tilla për kërkesat korruptive të zyrtarëve.
- Duhet vëmendje speciale për të thjeshtuar ligjet rreth tatimit të riimbursueshëm, siq është Tatimi mbi Vlerën e Shtuar. Nëse koha e nevojitur për të riimbursuar TVSH-në është e gjatë, kjo do të dekurajojë sjelljen bindëse, pastaj pa marrë parasysh nivelin e taksave, sjellja shmangëse do të ketë më shumë gjasa.

MBI STRATEGJINË E AUDITIMIT:

- Niveli i auditimit nuk duhet të jetë i rastit; por, duhet të vendoset sipas karakteristikave të firmës. Strategjia e Kosovës momentalisht është për të audituar firmat e mëdha, në mënyrë që të maksimizohen të hyrat e mbledhura në kontekstin e resurseve njerëzore të limituara. Kjo strategji mund të nënkuptojë që shmangësit e vërtetë mund të mos vërehen.
- Fokusimi i auditimit në sektorët që kanë normë të lartë të transaksioneve të keshit. Në këta sektor obligimi ligjor për marrjen e faturave nga konsumatorët do të lehtësonte angazhimin dhe eficiencën e inspektorëve tatimor.

- Optimizimi i auditimit që të trajtojë barazisht konkurrentët brenda llojit, p.sh. konkurrentët me karakteristika të njëjta (madhësi, sektor, regjion). Auditimi i barabartë, apo përshpikjejo-diskriminuese, do të përmirësonte perceptimin rreth drejtësisë së administratës tatimore.

MBI MORALIN TATIMOR:

- Moraliteti, besimi, normat sociale dhe tjera vlera etike janë pjesë e një sistemi fiskal. Një marrëdhënie e shëndoshë në mes të atyre që paguajnë tatim dhe atyre që shpenzojnë tatimin krijon një sinergji për një ambient fiskal fer, që pastaj përmirëson edhe më shumë lidhjen.
- Adoptimi dhe përforcimi i politikave të forta anti-korruptive. Kjo do të ulte evazionin fiskal duke ngritur bindjen e vullnetshme dhe përmes performancës më të mirë të mekanizmave përforcues.
- Më tepër sesa të përmirësojnë transparencën dhe përgjegjëshmërinë, qeveritë duhet të përmirësojnë lidhjen në mes të të hyrave të mbledhura dhe të shpenzimeve. Kjo do të ketë përgjigje pozitive nga taksapaguesit kundrejt qeverisë dhe institucioneve tjera relevante.
- Duhet të përdoret turpi moral si mjet për të përmirësuar shkallën e mbledhjes tatimore. Shmangësit dhe zyrtarët e korruptuar duhet publikisht të përgjigjen në mënyrë që të dekurajohen veprat e tilla në të ardhmen. Për më tepër, institucionet duhet të përdorin kampanja publike rreth rëndësisë së pagesës së tatimeve për taksapaguesit dhe përputhshmëria tatimore që duhet të mendohet si akt patriotik.
- Përmirësimi i eficiencës dhe modernizimi i administratës publike; sidomos në atë pjesë të administratës që është në kontakt të përditshëm me bizneset.

MBI INFORMALITETIN E FUQISË PUNËTORE:

- Rritja e presionit të bizneset përmes kampanjave që promovojnë benefitet nga kontributet sociale dhe pensionale në aspekt afatgjatë. Kjo do të bënte punëtorët të kërkojnë më shumë të drejta.
- Punë intensive në kontrata kolektive, ku disa të drejta të punëtorit përforcohen.
- Ulje e barrës financiare në ligjin aktual, me fokus në pushimin e lehonisë, që femrat mos të jenë subjekt i kontratave afat-shkurtë dhe diskriminimit në punë.
- Veprim i targetuar ndaj industrive më të pambrojtura ku nën-deklarimi i punëtorëve është më i përhapur. Në këtë rast, veprimi duhet të jetë fer dhe i balancuar kundrejt të gjitha industrive për t'u siguruar që produktiviteti industrial nuk bie si pasojë.
- Ngritja e potencialit për rritje përmes fitimeve më të mëdha për punëtorët informal. Kjo do të mund të ekzekutohej përmes trajnimeve profesionale.

7. REFERENCAT

- Abdixhiku, L. Pugh, G. and Hashi I. (2013). Determinants of Business Tax Evasion in Transition Economies: A Panel Investigation. Working Paper
- Allingham, M. and Sandmo, A. (1972). Income Tax Evasion: A theoretical Analysis.
- Alm, J. and Mccellan, C. 2012. Tax Morale and Tax Compliance from the Firm's Perspective.
- Anderoni, J., Erard, B. and Feinstein, J. 1998. Tax Compliance
- Bangasser, P. 2000. The ILO and the Informal Sector: an Institutional History. [report] Geneva: International Labour Organization.
- Becker, G. 1968. Crime and punishment: an economic approach.
- Bernabè, S. 2002. Informal Employment in Countries in Transition: A conceptual framework. [report].
- Bernabè, S. 2008. Measuring Informal Employment in Transition Countries. [report].
- Chen, M. 2004. Rethinking the Informal Economy: Linkages with the Formal Economy and the Formal Regulatory Environment. Helsinki.
- De Soto, H. 1989. The Other Path: The Invisible Revolution in the Third World. New York.
- Feld, L. and Frey, B. 2007. Tax Evasion, Tax Amnesties and the Psychological Tax Contract.
- Gërxhani, K. 1999. The Informal Sector in Developed and Less Developed Countries. [report] Amsterdam.
- Gërxhani, K. and Schram, A. 2002. Tax evasion and the source of income. [report].
- Hanousek, J. and Palda, F. 2004. Mission Implausible II: Measuring the Informal Sector in a Transition Economy Using Macro Methods. [report].
- Hazans, M. 2011. Informal Workers Across Europe: Evidence from 30 Countries. [report].
- International Labour Organization. 1972. Measuring informality: A statistical manual on the informal sector and informal employment. [report] Geneva: International Labour Organization.
- Kanbur, R. 2009. Conceptualising Informality: Regulation and Enforcement. Cornell University.
- KUCERA, D. and RONCOLATO, L. 2008. Informal employment: Two contested policy issues. [report] International Labour Organization.
- Kunt, A., Klapper, L. and Panos, G. 2008. Entrepreneurship in Post-Conflict Transition: The Role of Informality and Access to Finance.
- Lehmann, H. 2012. Labor Market Institutions and Informality in Transition and Latin American Countries. University of Bologna and IZA.
- Mintz, N. 2008. To what extent can the informal economy concept adequately explain the dynamism of the non-formal sector in developing countries.
- Nur-tegin. (2008). Determinants of tax evasion by firms. USA. 2002. 4,538 firms in 23 countries. Survey from. Business. Environment and. Tax evasion
- OECD. 2004. Informal Employment and Promoting the Transition to a Salaried Economy. [report].
- Ordóñez, J. 2010. Informal Sector, Productivity and Tax Collection. [report].
- Ruffer, T. and Knight, J. 2007. INFORMAL SECTOR LABOUR MARKETS IN DEVELOPING COUNTRIES. Oxford Policy Management.
- Rutkowski, J. 2006. LABOR MARKET DEVELOPMENTS DURING ECONOMIC TRANSITION.
- Schneider, F. 2012. The Shadow Economy and Work in the Shadow: What Do We (Not) Know? Bonn.
- Simons, R. and Lake, Z. 2006. Options for generating indicators on informal employment using the labour force survey: Part one: An informal sector module for the labour force survey.
- Smith, P. 1994. Assessing the Size of the Underground Economy: The Canadian Statistical Perspectives. Canadian Economic Observer, Catalogue No. 11-010, 3.16-33.
- Torgler, B., Schneider, F. and Schaltegger, C. 2010. Local Autonomy, Tax Morale, And The Shadow Economy.
- UNDP. 2012. Human Development Report. [report] Prishtina: UNDP.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

658:338.2(496.51)(048)

Të paguash apo të mos paguash : informaliteti nga kënvështrimi i bizneseve në Kosovë / Përgatitur nga Instituti Riinvest ; [Etida Zeka...et al.]. - Prishtinë : Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest, 2013. - 33 f. : ilustr.; 28 cm.

Shkurtesat : f. 5. - Parathënie : f. 7. - Referencat : f. 33

1.Zeka, Etida

ISBN 978-9951-430-43-2



ISBN 978-9951-430-43-2



9 789951 430432